

EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6094
E shtunë, 22 gusht 2020
çmimi 0.40 €

Kosova përkujton
kryeministrin e parë
të pasluftës FAQE 7



SHTYHET PËR DY DITË TAKIMI KOSOVË - SERBI NË SHTËPINË E BARDHË? FAQE 4-5

TAKIMI I UASHINGTONIT MUND TË SJELLË VETËM MARRËVESHJE EKONOMIKE



Analistët politikë nuk presin që në takimin e ardhshëm në Uashington të ndodhë marrëveshja përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Ilir Ibrahim i dha

Mushkolaj kanë deklaruar për "Epokën e re" se nga takimi në Shtëpinë e Bardhë, i cili pritet të mbahet më 4 shtator, mund të pritet vetëm ndonjë marrëveshje

ekonomike ndërmjet dy vendeve. Edhe përfaqësuesit më të lartë të dy shteteve kanë bërë me dije se në këtë takim pritet të diskutohet për çështje ekonomike

TALAT XHAFERI RIZGJEDHET KRYETAR I KUVENDIT TË MAQEDONISË SË VERIUT FAQE 2

Talat Xhaferi eshtë rizgjedhur kryetar i Kuvendit të Maqedonisë. Në favor të tij kanë votuar 62 deputetë nga

koalicioni LSDM-BDI. Kundër zgjedhjes së tij janë deklaruar partitë opozitore, duke përfshirë edhe ato

shqiptare. Zgjedhja e Xhaferit në krye të Kuvendit i ka hapur rrugë formimit të qeverisë së re



**KURTI: ME GRENELLIN DUHET TË VEPROJMË SI
ME GELBARDIN, TA KUNDËRSHTOJMË NJËZËRI** FAQE 5

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

[facebook.com Gazeta "Epoka e re"](#)

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

OPINION

SHQIPTARËT KURRË NUK
E KANË DËMTUAR SERBINË,
GJITHNJË KANË PËSUAR
PREJ SAJ (33) F. 11

Shkruan:
Kudusi LAMA



AKTUALE

THAÇI PRANON LETRAT
KREDENCIALE NGA
AMBASADORI I RI I ZVICRËS F. 6

PROJEKTIGJI PËR
QEVERTËN DËRGOHET NË
KOMISION TË VENECIAS F. 6

RAPORTI 24-ORËSH PËR
COVID: 10 TË VDEKUR,
220 TË SHËRUAR DHE 162
RASTE TË REJA NË KOSOVË F. 3

EKONOMI

ASK-ja: GJATË MUAJIT
KORRIK NË KOSOVË U
IMPORTUAN MALLRA ME VLERË
306.3 MILIONË EURO F. 9

MUSTAFË PREMTON
MBËSHTETJE PËR FERMERËT
E LIPJANIT F. 8

KULTURË

Akad. Prof. dr. Edmond Pinguli
vlerëson lartë krijimtarinë shkencore
të Prof. dr. Eqrem Zenelajt

HISTORI
MONUMENTALE F. 16

Akad. Prof. dr.
Edmond PINGULI



RENOVA PUTZ
Makedoni Xheqishti-Tetovë Curë-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755 Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË


Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A.
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

Bideni zotohet ta bashkojë kombin dhe t'i japë fund "etapës së errësirës"

WILMINGTON, 21 GUSHT - Ish-nënpresidenti i ShBA-së, Joe Biden, ka pranuar edhe zyrtarisht emërimin e Partisë Demokratike kandidat i saj për zgjedhjet presidenciale më 3 nëntor. Në fjalin e tij, Bideni është zotuar se do t'i japë fund “ditëve kur Amerika i merr me të mirë diktatorët”. “Unë do të jem një president i cili do të qëndroj me aleatët dhe miqtë tanë dhe do t'ua bëj të qartë kundërshtarëve tanë, se ditët kur diktatorët janë marrë me të mirë kanë mbaruar”, ka thënë Bideni në një fjali brenda një salle boshe në qytetin e tij të lindjes së Wilmington, Delaware, në ditën e fundit të Konventës Kombëtare të partisë që u mbajt online. Deklarata e tij kishte të bënte me perceptimin se presidenti i ShBA-së, Donald Trump, ka një



miqësi me liderë, si presidenti rus, Vladimir Putin dhe udhëheqësi i Koresë së Veriut Kim Jong Un. Bideni ka thënë se ai po punon në një strategji kombëtare për ta luftuar koronavirusin dhe do ta zbatonte atë në "ditën e parë" të presidencës së tij. Ai ka theksuar se ishte "e

pafalshme” që politika e Trumpit kishte dështuar për t’i mbrojtur amerikanët nga virusi vdekjeprurës. Bideni, gjithash-tu, është zotuar ta bashkojë vendin, i cili është shkatërruar nga protestat që kërkojnë drejtësi racore. Protestat janë nxitur nga vrasjet e afrikanëve

të paarmatosur nga oficerët e policisë. "Këtu dhe tani po ju jap fjalën time, nëse ma besoni presidencën, unë do ta tërheq më të mirën në drejtim tonin dhe jo më të keqen", ka thënë Bideni, duke shtuar se do të jetë një aleat i drithës dhe jo i errësirës sonë. "Të bashkuar ne mund dhe do ta kapërcejmë këtë etapë të errësirës në Amerikë", ka thënë ai.

Pasi Konventa përfundoi punimet, fishekzjarrët janë ndezur jashtë në quell, duke shënuar një arritje të madhe në karrierën politike të Bidenit, i cili edhe dy herë të tjera ka synuar kandidaturën për president.

Bashkë me Bidenin, për postin e nënpresidentes kandidon senatorja e Kalifornisë, Kamala Harris.

Trumpi, 74 vjec, do të riemëro-

het zyrtarisht si kandidati i Partisë Republikane gjatë Konventës Kombëtare Republikane javën e ardhshme. Trumpi qëndron pas Bidenit në sondazhe pasi votuesit shprehin pakënaqësi lidhur me përgjigjen e administratës së tij ndaj pandemisë së koronavirusit, e cila ka mbytur më shumë se 174 mijë amerikanë, si dhe për padrejtësitë racore. Presidenti ka zhvilluar një ngjarje fushate më herët më 20 gusht afér vendlindjes së Bidenit në Scranton, Pensilvani. Trumpi ka thënë se Bideni përfaqëson të majtën radikale dhe paralajmëroi se nëse ai zgjidhet, taksat mbi të ardhurat personale në Amerikë do të rriten edhe më shumë si dhe trazira do të ndodhin në qytetet e mëdha.

Talat Xhaferi rizgjedhet kryetar i Kuvendit të Maqedonisë së Veriut

Talat Xhaferi është rizgjedhur kryetar i Kuvendit të Maqedonisë. Në favor të tij kanë votuar 62 deputetë nga koalicioni LSDM-BDI. Kundër zgjedhjes së tij janë deklaruar partitë opozitare, duke përfshirë edhe ato shqiptare. Zgjedhja e Xhaferit në krye të Kuvendit i ka hapur rrugë formimit të qeverisë së re.

SHKUP, 21 GUSHT - Kuvendi i Maqedonisë së Veriut me 62 vota për ka rizgjedhur Talat Xhaferin kryetar të këtij institucioni. Zgjedhja e tij në këtë pozitë është bërë me propozim të LSDM-së dhe të BDI-së. Sipas këtyre dy partive, Xhaferi gjatë mandatit të deritashëm ka dëshmuar se me sukses mund ta drejtojë këtë institucion, andaj edhe i kanë dhënë mbështetjen. “Talat Xhaferi është njeriu i duhur në vend të duhur. Ai është kryetari më i suksesshëm i Kuvendit, njeriu që i ka thyer tabutë se shqiptari jo vetëm se mund të jetë kryetar Kuvendi, por edhe



Kuvendit gjatë trazirave më 27 prill 2017)", ka deklaruar Zeqiri. Kundër kryetarit të ri të Kuvendit është shprehur edhe opozita maqedonase, duke drejtuar kritika për mënyrën e drejtimit të Kuvendit në të kaluarën, në veçanti në raport me opozitën. "Mosrespektimi i opozitës, refuzimi për çeljen e debatit për amendamentet e opozitës, ndërprerja e diskutimeve, shkelja e procedurave parlamentare, shkelja e Rregullores mbi Punën

e Kuvendit janë vetëm disa nga çështjet që kanë karakterizuar punën e Talat Xhaferit si kryetar Kuvendi. Nëse këto konsiderohen si punë e suksesshme e tij, atëherë kjo shumicë ka problem me përkufizimin e të qenës demokratik. Xhaferi nuk ka mbështetjen e opozitës", ka deklaruar Nikolla Micevski nga VMRO-DPMNE-ja.

ndaj shumicës së re parlamentare i kishte kryesisht për, siç ka thënë, dhunimin e votës shqiptare në zgjedhjet e 15 korrikut. Nga ky koalicion kanë deklaruar se qëllimi i tyre kryesor në punën e Kuvendit, do të jetë mbrojtja e demokracisë. “Si koalicion nuk do të lejojmë t’i shkelim premtimet e dhëna të 82 mijë votuesve dhe të tyre 10 mijë të tjerëve që dolën në protesta me akuza drejtuar BDI-së pér vjedhje. Pra, nuk do të lejojmë që të shkelet besa e dhënë njerëzve të cilët kanë kërkuar demokraci, por që BDI-ja dhe Talat Xhaferi së bashku edhe me Ali Ahmetin, e mohuan këtë demokraci”, ka deklaruar Skënder Rexhepi nga koalicioni opozitar shqiptar.

Për ta zgjedhur kryetarin e Kuvendit janë nevojitur së paku 61 vota nga 120 deputetë sa numëron Kuvendi i Maqedonisë së Veriut. Zgjedhja e kryetarit të Kuvendit i ka hapur rrugë votimit të qeverisë së re të përbërë nga LSDM-ja dhe BDI-ja.

Turqia bën 'zbulimin më të madh' të gazit natyror në Detin e Zi

STAMBOLL, 21 GUSHT - Turqia ka zbuluar rreth 320 miliardë metra kub të gazit natyror në gjirin e Detit të Zi, ka bërë me dije presidenti turk Rexhep Tajip Erdogan, duke e konsideruar këtë gjë "si lajm të mirë të një rëndësie historike" për shtetin që varet pothuajse krejtësisht nga energjia e importuar. "Turqia ka bërë zbulimin më të madh në histori të gazit natyror në Detin e Zi", ka thënë




Erdogan në një fjalim televiziv nga Stambolli. Megjithatë, analistë të industrisë kanë thënë se ndonëse sasia është e madhe, ajo nuk do ta kthejë Turqinë në zonë rajonale të energjisë dhe nuk do të ndikojë në pasurinë e shtetit.

Anija e shpimit "Fatih" ka gjetur depozitën në zonën e gazit, Sakarya, në qytezën verilindore, Zonguldak, ka thënë Erdogan, duke shtuar se

emrin sipas Sulltan Mehmetit II, i cili ka sjellë Konstadinopojën - Stambollin e ditëve të sotme - nën regjimin otoman më 1453. Turqia ka qenë në kërkim të hidrokarbureve në Detin e Zi dhe Detin Mesdhe, ku së fundmi me veprimet e veta në ujërat e kon-testuara, ka nxitur reagime të Greqisë dhe Qipros. Megjithatë, presidenti turk ka thënë se vendi që drejtton ai do

Raporti 24-orësh për Covid: 10 të vdekur, 220 të shëruar dhe 162 raste të reja në Kosovë



Gjatë 24 orëve të fundit në Kosovë kanë vdekur dhjetë persona si pasojë e infektimit me Covid. IKShPK-ja ka njoftuar se gjatë kësaj periudhe janë shëruar 220 persona dhe janë paraqitur 162 raste të reja me virusin "Korona". Sipas IKShPK-së, numri i përgjithshëm i të shëruarave me Covid ka shkuar në 8 149, ndërsa i të vdekurve në 448.

EPOKA ERE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 21 GUSHT (ER) - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se në 24 orët e fundit kanë ndërruar jetë dhjetë persona si pasojë e Covid-19. Sipas IKShPK-së, gjatë kësaj kohe janë shëruar 220 pacientë, kurse janë regjistruar 162 raste të reja me Covid-19. "Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në

IKShPK me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 584 mostra të marra nga ShSKUK, gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren dhe laboratorët private, prej të cilëve rezultojnë 162 raste pozitive. Brenda 24 orëve janë raportuar 10 raste të vdekjes me SARS CoV-2 pozitiv. Numri total i rasteve pozitive është 12 168 raste nga 46 452 persona të dyshimtë në virusin SARS-CoV-2 dhe 448 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit, janë shëruar 220 pacientë derisa numri i

përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 8 149 raste, kurse numri i rasteve aktive është 3 571", ka njoftuar IKShPK-ja, duke treguar edhe numrin e rasteve të reja me Covid sipas komunave. "Rastet pozitive janë nga: komuna Prishtinë 47 raste, komuna Mitrovicë 12 raste, komuna Vushtrri 11 raste, komuna Ferizaj 10 raste, komuna Fushë Kosovë 10 raste, komuna Podujevë 10 raste, komuna Dragash 7 raste, komuna Prizren 7 raste, komuna Pejë 6 raste, komuna Drenas 5 raste, komuna Gjakovë 5 raste, komuna Shtime 5 raste, komuna Skenderaj 5 raste, komuna Viti 5 raste, komuna Suharekë 4 raste, komuna Gjilan 3 raste, komuna Lipjan 3 raste, komuna Kaçanik 2 raste, komuna Klinë 2 raste dhe me nga një rast komunat Han i Elezit, Istog dhe Kamenicë", ka njoftuar IKShPK-ja.

KMDLNj: Qytetarët t'i padisin institucionet nëse nuk iu kompensohen shpenzimet e testit për Covid

Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka vlerësuar se shëndeti publik i qytetarëve të Kosovës është vënë në sprovë për shkak të pandemisë së shkaktuar nga Covid-19. KMDLNj-ja si shkaktar të dështimit të menaxhimit me virus e ka vënë politikën aktuale në vend. "Në menaxhimin e pandemisë së shkaktuar nga Covid-19 ka dështuar politika, e papërgatitur me këto situata, e shquar për joseriozitet dhe jokompetencë e cila interesin politik, partiak dhe personal e ka vënë mbi interesin e mbrojtjes së shëndetit publik. Në pamundësi dhe pazotësi që ta rrisë numrin e testimeve, si masë e vetme efikase parandaluese, këtë kompetencë ua ka bartur laboratorëve privatë për të cilët askush, në mungesë të transparencës, nuk e di se cilat kritere kanë qenë përcaktuese për dhënie të lejes", është thënë në reagimin e KMDLNj-së.

Më tutje, KMDLNj ka theksuar se pas licencimit të laboratorëve privatë për testime me Covid është rritur mundësia për zhvatjen e qytetarëve. "Edhe çmimet janë

në shpërputhje të madhe me mundësitë materiale të shumicës së qytetarëve të Kosovës. Numri i laboratorëve privatë është rritur shumë dhe me këtë edhe mundësia e zhvatjes së qytetarëve të Kosovës. Laboratorët privatë bëjnë teste serologjike dhe në të shumtën e rasteve udhëzojnë pacientët të bëjnë testin anti-Covid si dhe analiza plotësuese të gjakut e që për një person shuma shkon midis 85-100 euro", është thënë në reagimin e KMDLNj-së.

Ky këshill ka theksuar se institucionet e Kosovës në mënyrë flagrante janë duke i shkelur të drejtat e njeriut duke mos i mbrojtur ato. Me këtë rast, KMDLNj ka ftuar qytetarët që t'i padisin institacione në rast se nuk kompensohen për testet për Covid-19 dhe shpenzimet e tjera e që janë përgjegjësi eksklusive e shtetit.

Mbi 500 pacientë me Covid të shtrirë në spitalet publike të Kosovës

Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) ka njoftuar të premten se në institucionet publike shëndetësore në Kosovë aktualisht janë të shtrirë 516 pacientë, prej tyre 395 janë të prekur me koronavirus. Në reportin ditor të ShSKUK-së është thënë se 18 pacientë janë në respiratorë, 27 janë duke u trajtuar me makinat e frysëmarrjes CPAP, kurse 347 të tjera janë në oksigenoterapi. Kosova ka gjithsej 700 shtretër në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës dhe në spitalet rajonale. Këtij vendi të premten i janë shtruar 162 raste të reja me koronavirus, pas marrjes së 548 mostra. Prej 13 marsit, kur janë regjistruar rastet e para me koronavirus në Kosovë, Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka raportuar për 12 168 të infektuar me këtë virus.

Qeveria ndan 360 mijë euro për aparatura mjekësore për testim për Covid

Me kërkesë të Ministrisë së Shëndetësisë, Qeveria e Kosovë ka ndarë 360 mijë e 170 euro për blerjen e aparaturave mjekësore për testim për Covid-19. Me këtë rast, kryeministri Avdullah Hoti ka thënë se janë duke vazhduar investimet në

institucionë të shëndetësisë për luftë kundër Covidit. "Në mbledhjen e sotme, Qeveria e Kosovës, me kërkesë të Ministrisë se Financave, ka marrë vendim për ndarjen e shumës prej 360 170 eurosh në bazë të kërkesës së Ministrisë së

Shëndetësisë, për qëllim të financimit të aparaturave mjekësore për testim për Qendrat Rajonale të Shëndetit Publik dhe IKShPK-së, bazuar në planin e miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës", është shprehur Hoti.



Shtyhet për dy ditë takimi Kosovë - Serbi në Shtëpinë e Bardhë?

Takimi i Uashingtonit mund të sjellë vetëm marrëveshje ekonomike

Analistët politikë nuk presin që në takimin e ardhshëm në Uashington të ndodhë marrëveshja përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Ilir Ibrahim i dhe Imer Mushkolaj kanë deklaruar për "Epokën e re" se nga takimi në Shtëpinë e Bardhë, i cili pritet të mbahet më 4 shtator, mund të pritet vetëm ndonjë marrëveshje ekonomike ndërmjet dy vendeve. Edhe përfaqësuesit më të lartë të dy shteteve kanë bërë me dije se në këtë takim pritet të diskutohet për çështje ekonomike

**EPOKA
ERE** Muhamet KOÇI

PRISHTINË, 21 GUSHT - Njohësit e rrethanave politike kanë mohuar mundësinë se në takimin e ardhshëm ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në Shtëpinë e Bardhë mund të arrihet ndonjë marrëveshje përfundimtare. Ata kanë bërë me dije se në këtë takim mund të arrihet vetëm ndonjë marrëveshje ekonomike në mes të dy vendeve. Analisti politik Ilir Ibrahim ka bërë me dije se ende nuk janë arritur kushtet që në këtë takim të arrihet marrëveshja finale. "Pas

dështimit të takimit të qershorit, dhe pas një illoj pauze të angazhimit amerikan, është lajm i mirë që takimi do të ndodhë në shtator. Përveç peshës simbolike që ka një takim në Shtëpinë e Bardhë, është shumë inkurajes fakti që ky takim organizohet nën ombrellën e Këshillit të Sigurisë Kombëtare të ShBA-së dhe kjo duhet të mirëpritet dhe përshëndetet. Duke pasur parasysh të gjithë konstelacionin e zhvillimeve në Bruksel dhe Uashington, nuk pres që do të ketë ndonjë marrëveshje finale, por mund të

presim ndonjë marrëveshje për çështje ekonomike si dhe arritje e ndonjë mirëkuptim se çfarë pritet të arrihet me marrëveshjen përfundimtare", ka thënë Ibrahim për "Epokën e re". As analisti Imer Mushkolaj nuk pret ndonjë zhvillim politik nga ky takim. Ai ka thënë për gazetën "Epoka e re" se në këtë takim të dy vendet do ta konfirmojnë përkushtimin e tyre për marrëveshjen finale. "Takimi i 2 shtatorit do të jetë konfirmimi i përkushtimit për arritjen e marrëveshjes finale Kosovë - Serbi, por mund të arrihet edhe

ndonjë marrëveshje e karakterit ekonomik. ShBA-ja e ka bërë të quartë se përgjegjësia kryesore për arritjen e marrëveshjes politike i takon Brukselit por, natyrisht, roli i ShBA-së është thelbësor. Kosova duhet ta kuptojë drejt këtë përkushtim amerikan dhe duhet ta kapitalizojë sa më shumë në interes të vetin", ka thënë Mushkolaj.

Edhe kryeministri Avdullah Hoti ka bërë me dije se në këtë takim do të flitet për çështje ekonomike. "ShBA-ja ka qenë gjithmonë vendimtare në procesin e shtetndërtimit të Kosovës. Më 2 shtator takohemi në Shtëpinë e Bardhë për të diskutuar me palën serbe, si dy vende të pavarura, për projekte madhore të bashkëpunimit ekonomik që do ta ndërrojnë perspektivën ekonomike të Kosovës dhe rajonit. Kosova është e bekuar me miqtë që ka", pati shkruar Hoti në profilin e vet në "Facebook".

Por ndryshe mendon partneri kryesor i Hotit në koalicionin qeverisës. Kryetari i Aleancës për Ardhmérinë e Kosovës, Ramush Haradinaj, ka deklaruar se në takimin në Uashington, Kosova duhet të shkojë për marrëveshje përfundimtare me Serbinë. "Po shkojmë për marrëveshje, për njohje reciproke në kufi ekzistues. Nëse rrethanat e sjellin këtë marrëveshje, po shkojmë për këtë marrëveshje, por nëse ka përparim, marrim edhe përparimin, cilidhoqfë ai", ka deklaruar Haradinaj. Ndaj pritjeve të Haradinajt ka reaguar presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiç. Ai ka thënë se në këtë takim mund të ketë bisedime në mes të Kosovës dhe Serbisë vetëm për temat e përcaktuara më herët dhe se nuk do të ketë marrëveshje përfundimtare atje. "Ne po shkojmë në Uashington për të diskutuar tema të përcaktuara. Mund të flasim për çdo temë, por ata të marrin të gjitha e ne asgjë,





dhe t'i njohim, atë film nuk do ta shohin", ka thënë Vuçiqi.

Megjithatë, ai ka pranuar se bisedimet e ardhshme nuk do të jenë të lehta. I dërguari i Shtëpisë së Bardhë për dialogun, Richard Grenell, më 14 gusht ka njoftuar se më 2 shtator Kosova dhe Serbia do të takohen në Uashington. Kësaj fte se i janë përgjigjur pozitivisht kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, dhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq. I vetmi që

është shprehur kritik ndaj këtij takimi ka qenë ish-kryeministri, lideri i LV-së, Albin Kurti, i cili këtë takim e ka ndërlidhur me zgjedhjet presidenciale në ShBA që pritet të mbahen në nentor. Takimi i parë i këtij lloj në Shtëpinë e Bardhë ishte paraparë të mbahet më 27 qershori por, për shkak të publikimit të aktakuzës së Gjykatës Speciale për presidentin Hashim Thaçi, ky takim ishte anuluar.

Shtyhet për dy ditë takimi Kosovë - Serbi në Shtëpinë e Bardhë?

Është shtyrë për dy ditë takimi i paralajmëruar për 2 shtator ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në Shtëpinë e Bardhë, ka bërë me dije "Zëri i Amerikës", duke cituar disa burime. Ky medium nuk ka dhanë ndonjë hollësi tjetër për arsyet e shtyrjes së takimit, mikpritës të të cilit do të jenë këshilltari për Siguri Kombëtare, Robert O'Brien, së bashku me ambasadorin Richard Grenell, i dërguar i posaçëm i presidenti Donald Trump për bisedimet e paqes Kosovë - Serbi.

Gjatë të premtes edhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ka deklaruar rreth raportimeve për mundësinë

e shtyrjes së takimit të 2 shtatorit që është paralajmëruar të mbahet në Shtëpinë e Bardhë në Uashington. Vuçiqi ka thënë se mund të ketë një shtyrje të datës për disa ditë. "Ekziston një iniciativë për lëvizjen e datës. Unë do të jap një përgjigje. Nuk mendoj se kjo do të jetë e lehtë. A ndiej personalisht një barrë të madhe? Po, por ajo që mund të garantoj është se unë do të luftoj për interesin e Serbisë, dhe ajo që disaën dërrrojnë, pavarësinë, nuk do të ndodhë", ka thënë Vuçiqi para gazetarëve në Batajnici, ku ka marrë pjesë në një ushtrim të njësive të Forcave Ajrore të Ushtrisë Serbe, raporton "B92".

Kurti: Me Grenellin duhet të veprojmë si me Gelbardin, ta kundërshtojmë njëzëri

PRISHTINË, 21 GUSHT (ER) - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka deklaruar se para tri ditëve kishte pranuar njoftimin për një kërkesë nga Ambasada e Kosovës në ShBA, të nënshkruar nga 25 veprimtarë shqiptarë, për të marrë pjesë në një takim virtual të përbashkët me kërket e institucioneve shtetërore e të partive politike, për të diskutuar përspektivën e strategjitet e veçanta e të përbashkëta të subjekteve të Kosovës në lidhje me procesin e bisedimeve në mes të Kosovës dhe Serbisë. Në profilin e vet në "Facebook", ai ka bërë me dije se ka refuzuar këtë ftesë për arsy se, sipas tij, një takim i tillë do të legjitimonte një proces i cili po zhvillohet tërësisht në mungesë të respektit për qytetarët, institucionet dhe demokracinë e Kosovës.

Ai sërisht ka kritikuar përfaqësuesin special të ShBA-së për bisedimet Kosovë - Serbi, Richard Grenell. Kurti ka thënë se Kosova Grenellin duhet ta

kundërshtojë njëzëri ashtu siç kishte vepruar me ish-ambasadorin Gelbard, i cili në vitin 1998 kishte thënë se UÇK-ja është terroristë. "Sa i përket të dërguarit të posaçëm Grenell, meqenëse ai ka thënë se Kosova duhet ta heqë reciprocitetin me Serbinë, mendoj se duhet të veprojmë me të njësoj siç vepruan me ambasadorin Gelbard, kur më 1998 tha se UÇK-ja është terroristë. Pra, ta kundërshtojmë njëzëri, në mënyrë që ta kuptojë se kjo qasje është e papranueshme për ne. Asokohe kundërshtimi ynë bëri që Gelbard të zëvendësohet nga Holbrooke, pra ia pamë hairin kundërshtimit. Edhe sot na duhet që Richard Grenelli të zëvendësohet me një Richard Holbrooke të ri", ka shkruar Kurti, duke treguar arsyet e mospjesëmarres në këtë takim. "Takimi mes udhëheqësve të institacioneve dhe kryetarëve të partive parlamentare do të kishte kuptim nëse qeveria do të

kishte përgatitur një platformë me kërkesa ndaj Serbisë, të cilën do të duhet ta paraqiste në Kuvend për ta kërkuar miratimin e 2/3 të deputetëve. Veprimi i qeverisë pa platformë, apo me platformë që i mbahet fshehur Kuvendit, jo vetëm që e fyen demokracinë dhe ne si subjekt më i madh parlamentar, por e dëmton interesin kombëtar. Përveç kësaj, si mund të marrim pjesë në një takim të përbashkët me një figurë si presidenti i Kosovës, i cili vetë mbështet një plan krejt tjetër, për ta paguar Serbinë me copëtim të Kosovës nën petkun e shkëmbimit territorial? Ne nuk mendojmë se Kosova i ka borxh Serbisë diçka, dhe nuk dëshirojmë që përmes pjesëmarres në takime ta zbusim sadopak mungesën e legjimititetit të atyre që kanë delegjitimuar vetveten. Njohja e Kosovës nuk është diçka që ne mund ta blejmë, atë mund ta fitojmë duke ndërtuar e forcuar shtetin, ekonominë dhe demokracinë", ka shkruar Kurti.



Hoti thotë se do t'i marrin masat e nevojshme për fillim të vitit të ri shkollor

PRISHTINË, 21 GUSHT (ER) - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka bërë me dije se do të merren masat e nevojshme për fillim të vitit të ri shkollor. Ai ka treguar se përkëtë çështje të premten ka takuar ministrin e Shëndetësisë, Armend Zemaj, drejtorin e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike (IShPK), Naser Ramadani dhe drejtorin e përgjithshëm të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK), Valbon Krasniqi. Hoti ka thënë se ka kërkuar që në të gjitha institucionet shkollore të ndërmerrin veprimet e nevojshme për respektimin e masave dhe protokollove të caktuara nga ekspertët e shëndetësisë. Në këtë takim u diskutua për gjendjen e përgjithshme epidemiologjike në vend, me theks të veçantë për menaxhimin dhe parandalimin e përhapjes së pandemisë Covid-19, ndaj kërkova, po ashtu, që institucionet e shëndetit publik dhe departamentet komunale të shëndetësisë t'i bëjnë përgatitjet e duhura, në mënyrë



që të kryhet me kohë edhe vaksinimi i qytetarëve ndaj gripit sezonal, si një masë mbrojtëse parandaluese ndaj përhapjes së pandemisë Covid-19", ka thënë Hoti.

Kërkohen një mijë mësimdhënës shtesë për fillimin e vitit shkollor

PRISHTINË, 21 GUSHT - Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka kërkuar nga Qeveria e Kosovës, që ta mundësojë angazhimin e 1 000 mësimdhënësve me pagesë për vitin e ri shkollor, që pritet të fillojë më 1 shtator. Angazhimi i këtyre mësimdhënësve, sipas zyrtarëve të kësaj ministrie, duhet të vlejë vetëm gjatë kohës së pandemisë së koronavirusit.

Enver Osdautaj, këshilltar i lartë politik në kabinetin e ministrit të Arsimit dhe Shkencës, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se ky numër i mësimdhënësve duhet të jenë si staf rezervë në rast të infektimit me



koronavirus apo izolimit të mësimdhënësve të rregullt. "Ne kemi kërkuar angazhim të rregullt të mësimdhënësve me gjysmë pagesë vetëm për periudhën e pandemisë. Kemi kërkuar nga Qeveria që të mbështesë me 1 000 mësimdhënës si staf rezervë dhe staf teknik, varësish nga nevojat. Këta mësimdhënës do të punojnë vetëm në rrethana pandemie. Këta janë mësues plotësues për t'i

plotësuar nevojat varësish prej situatave që vijnë dhe shpërndarja e tyre në nivel shteti bëhet në bazë të numrit të nxënësve nëpër drejtori komunale të arsimit", ka thënë Osdautaj.

Rritjen e stafit të personelit arsimor, për fillimin e procesit mësimor, e ka kërkuar edhe Këshilli i Prindërve i Kosovës. Ymret Reshit, kryetar i këtij Këshilli, në një bisedë për "Radio Evropa e Lirë", ka thënë se, përveç infektimit të mundshëm me sëmundjen Covid-19 të mësimdhënësve, stafi i ri duhet të ndihmojë edhe në rast të marrjes së vendimit për ndarjen e nxënësve në dy ose tri klasa. "Do të thotë, mos të jetë barrë e një mësimdhënësi

që të punojë në një klasë në tri grupe, sidomos e kemi fjalën për ato klasa që kanë numër të madh të nxënësve", ka thënë Reshit. Përveç kërkesës për 1 000 mësimdhënës shtesë me pagesë, Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka kërkuar edhe nga Universiteti i Prishtinës, konkretisht nga Fakulteti i Edukimit, që studentët të ndihmojnë në mbarëvajtjen e procesit mësimor. Këtyre studentëve do t'u nijhet praktika, proces ky që është obligim përfundimin e fakultetit. Ndërsa dekani i Fakultetit të Edukimit, Ethem Çeku, më herët kishte treguar gatishmërinë e këtij fakulteti për ta ndihmuar Ministrinë e Arsimit në procesin e mësimit.

Ministri Zemaj: Do t'i bëjmë realitet sigurimet shëndetësore



PRISHTINË, 21 GUSHT (ER) - Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, pas emërimit të bordit drejtues të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore, ka thënë se janë të përkushtuar dhe angazhuar maksimalisht që sa më parë të plotësohen të gjitha parakushtet në mënyrë që ky fond të jetë në funksion të plotë dhe t'u ofrohen qytetarëve sigurime shëndetësore dhe mburojë financiare.

"Bazuar në propozimin tim, sot Qeveria e Republikës së Kosovës e miratoi emërimin e bordit drejtues të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore si organi më i lartë vendimmarrës i fondit në pajtim me Ligjin për sigurimin shëndetësor. Po ashtu, grupi punues ka filluar punën për hartimin e ligjit për sigurimet shëndetësore. Do të insistoj që të punohet pa humbur kohë dhe me një

dynamikë të shpejtë për draftimin e tij. Fondi i Sigurimeve Shëndetësore është institucion i pavarur publik me përgjegjësi dhe autorizime të veçanta që, në emër të të siguruarve, t'i administrojë mjetet financiare për ofrimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor nga institucionet shëndetësore në të gjitha format e pronësise", ka thënë Zemaj.

Projektligji për qeverinë dërgohet në Komision të Venecias

PRISHTINË, 21 GUSHT (ER) - Zëvendëskryeministri i parë, Besnik Tahiri, ka bërë me dije se Projektligji për qeverinë është finalizuar.

Në mbledhje të qeverisë, ai ka treguar se për të parë se mos është ndesh me Kushitetutën, projektligji është dërguar në Komision

të Venecias për shqyrtim. Sipas tij, në muajin tetor pritet të vijë përgjigjja e këtij komisioni dhe më pas projektligji do të votohet.

"Ligji tani është final. Ne kemi vendosur 15 ministri dhe dy t'i mbesin mandatarit", ka dekluaruar Tahiri.



Tri vjet nga vdekja e ish-kryeministrit Bajram Rexhepi

Kosova përkujton kryeministrin e parë të pasluftës


Në trevjetorin e vdekjes është përkujtuar ish-kryeministri Bajram Rexhepi. Liderët institucionalë dhe politikë të vendit kanë deklaruar se kryeministri i parë i Kosovës ishte intelektual, humanist dhe politikan shumë i vendosur. Ata kanë vlerësuar lart kontributin e Rexhepit gjatë luftës çlirimtare, duke thënë se si mjeku i UÇK-së u shërbeu çlirimtarëve të plagosur, duke kryer deri edhe ndërhyrje të rënda kirurgjikale e shpëtuar jetë nëpër malet e rezistencës përliri.

**EPOKA
ERE** Muhamet KOCI

PRISHTINË, 21 GUSHT - Kosova e ka përkujtuar ish-kryeministrin Bajram Rexhepi në trevjetorin e vdekjes. Liderët institucionalë dhe politikë të Kosovës e kanë vlerësuar lart figurën e kryeministrit të parë të Kosovës, i cili njihet edhe si doktori i parë i UÇK-së. Presidenti Hashim Thaci ka thënë se Rexhepi ishte intelektual, humanist, diplomat dhe politikan shumë i vendosur. "Kryeministri i parë i Kosovës së pasluftës, Bajram Rexhepi, ishte figurë shembull e patriotizmit, i cili nuk e ndali asnjëherë kontributin përlirinë, pavarësinë dhe fuqizimin e shtetit të Kosovës", ka shkruar Thaci në profilin e vet në "Facebook", duke përmendur kontributin e madh në luftën çlirimtare. "Ai dha kontribut shumë të madh në vijën e parë të frontit të luftës, duke shpëtuar qindra jetë të ushtarëve të UÇK-së dhe duke iu mundësuar atyre që të kthe-

sheshin sërisht në istikamet e luftës përmbrojtjen e atdheut", ka shkruar Thaci.

Ndërsa kryeministri Avdullah Hoti, duke përkujtuar ish-kryeministrin e parë të Kosovës së pasluftës, Bajram Rexhepi, ka thënë se ai do të kujtohet përherë si një njeri me vlera të dëshmuara intelektuale, patriotike dhe humane në rrugëtimin përliri, pavarësi dhe demokraci. Edhe kryeministrit i Shqipërisë, Edi Rama, e ka përkujtuar ish-kryeministrin e Kosovës, duke thënë se ka pasur fatin dhe nderin ta njohë Bajram Rexhepin. "Bajram Rexhepi e përfjetoi dhimbjen e plagëve të luftës çlirimtare si mjeku i UÇK-së që u shërbeu çlirimtarëve të plagosur, duke kryer deri edhe ndërhyrje të rënda kirurgjikale e shpëtuar jetë larg sallës së operacionit, nëpër malet e rezistencës përliri. Ai u bë kryeministri i parë i gjithëpërvanuar i Kosovës, me mbështetjen e krejt forcave politike, kur dukej se askush s'mund ta merrte konsen-



susin e tyre dhe ishte i pari zyrtar i lartë i Kosovës së lirë që shkeli në Mitrovicën e dasisë së madhe, vendlindjen e tij, duke u bërë garanti i sigurisë përtë gjithë atje, kur pas mbytjes së dy fëmijëve shqiptarë në ujërat e Mitrovicës, valvuli i tensionit ndërëtnik ishte në një çast shpërthyesh", ka shkruar Rama në profilin e vet në "Facebook". Ndërsa lideri i PDK-së, Kadri Veseli, ka thënë se Rexhepi ishte politikan i ndershëm dhe kryeministër bashkues. "Kryeministri i parë i Kosovës, dr. Bajram Rexhepi, mbetet një nga figurat më emblematike të shtetit të ri dhe qytetit të Mitrovicës. Bajrami humanist ishte në vijat e para të frontit të luftës në ndihmë të civilëve e ushtarëve të plagosur të UÇK-së. Bajrami, politikan i ndershëm, pranoi njërin nga sfidat më

të vështira të pas luftës, duke shërbyer si kryeministri bashkues i Kosovës në njërin nga periudhat më të trazuara politike e shoqërore", ka shkruar Veseli në profilin e vet në "Facebook". Kurse lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka vlerësuar se Rexhepi mbetet në histori si një prej mjekëve të parë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. "Si personalitet, u shqua përfisnikërinë, përkushtimin dhe profesionalizmin e tij. Nuk do ta kujtojmë vetëm si kryeministër, por si një shqiptar të madh, kontribuuves përliri dhe ndërtues i paqes në vend", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook". Në prill të 2017-s ish-kryeministri u shtrua në QKUK për shkak të një sulmi shëndetësor në organet vitale, ndërsa më pas është dërguar në Turqi përshtë Jashtë vendit. Pas

në beteje prej pesë muajsh me sëmundjen, Rexhepi ndërroi jetë më 21 gusht 2017, duke lënë pas vetes bashkëshorten dhe vajzën. Bajram Rexhepi lindi në Mitrovicë më 3 qershor 1954. Studimet pas-universitare i kreu në Zagreb në vitin 1985. Punoi kirurg i përgjithshëm dhe specialist endoskopik në spitalin rajonal të Mitrovicës deri në vitin 1990. Rexhepi e kaloi shumicën e karrierës së vet si kirurg dhe fitoi famën si kirurgu më i mirë në rajonin e Mitrovicës. Gjatë luftës së Kosovës më 1999, Rexhepi u bashkua me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe kaloi tre muaj duke shërbyer mjek në terren. Ai shërbeu si kryetar i Mitrovicës jugore, duke punuar me paqeruajtjesit e Kombeve të Bashkuara dhe NATO-s për t'i zgjedhur trazirat civile.



Thaci pranon letrat kredenciale nga ambasadori i ri i Zvicrës

PRISHTINË, 21 GUSHT (ER) - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaci, ka pranuar të premten letrat kredenciale të ambasadorit të ri të Konfederatës së Zvicrës në Kosovë, Thomas Kolly. Thaci i ka uruar mirëseardhje ambasadorit Kolly dhe i ka shprehur mirënjohjen e Kosovës që Zvicra i ka

dhënë popullit të Kosovës përdokada me radhë. "Jemi mirënjohës përmështetjen në të kaluarën, por edhe përmështetjen që Konfederata e Zvicrës i jep shtetit të Kosovës sot", është shprehur kreuz shtetit.

Presidenti Thaci ka theksuar se në çdo takim, me çdo lider kosovar,

si ambasador i Zvicrës do ta marrë porosinë e bashkëpunimin dhe mbështetjes së vazhdueshme përvancimin e raporteve mes dy vendeve. Ndërsa ambasadori Kolly është shprehur i gjëzuar përdetyrën e re dhe shtoi se do të angazhohet përparrim të mëtutjeshëm të marrëdhënieve mes Zvicrës dhe Kosovës.



Miratohet nisma përmarrëveshjen për ndihmë Kosovë - Shqipëri në rast të fatkeqësive natyrore

PRISHTINË, 21 GUSHT (ER) - Qeveria e Kosovës të premten ka miratuar nismën përlidhjen e marrëveshjes me Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë përbashkëpunit të ndërsjellë në raste të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera. Gjatë prezantimit të kësaj pike në mbledhjen e qeverisë, ministri

i Punëve të Brendshme (MPB), Agim Veliu, ka thënë se kjo nismë është në frymën e interesave të përbashkëta në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe në të mirë të rritjes së sigurisë kombëtare. "Marrëveshja do t'i përcaktojë format e bashkëpunimit, procedurat e kalimit kufitar, ndihmës, kalimin e pajisjeve, stre-

himin dhe ndihmën e të zhvendosurve, përdorimin e avionëve etj.", ka thënë Veliu. Po në këtë mbledhje është marrë vendim për themelimin e Komisionit Mbikëqyrës përzbatimin e marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe Malit të Zi përhapjen e kalimit kufitar të përbashkët Kotlovë - Kuqishtë përrafiqun rrugor.

Linja e gazit Shqipëri - Kosovë kushton 211 milionë euro

TIRANË, 21 GUSHT - Korniza e Investimeve në Ballkanin Perëndimor, e cila funksionon në kuadër të procesit të Berlinit, njoftoi për përfundimin e studimit për një linjë të transmetimit të gazit nga Shqipëria në Kosovë, për t'u shtrirë më tej në Serbi. Studimi paraprak ka treguar se përfundimi i projektit do të kushtojë 211 milionë euro. Gjysma e shumës do të financohet nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim. Linja Shqipëri - Kosovë synon të krijojë një rrugë të re furnizimi me gaz natyror nga Lindja e Mesme dhe rajoni Kaspik i

Ballkanin Perëndimor, e cila funksionon në kuadër të procesit të Berlinit, njoftoi për përfundimin e studimit për një linjë të transmetimit të gazit nga Shqipëria në Kosovë, për t'u shtrirë më tej në Serbi. Studimi paraprak ka treguar se përfundimi i projektit do të kushtojë 211 milionë euro. Gjysma e shumës do të financohet nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim. Linja Shqipëri - Kosovë synon të krijojë një rrugë të re furnizimi me gaz natyror nga Lindja e Mesme dhe rajoni Kaspik i

transportuar nga tubacioni Trans - Adriatik për në verilindje të zonës së Ballkanit Perëndimor drejt Serbisë. Kjo linjë është planifikuar të lidhet me sistemin ekzistues dhe të planifikuar të transmetimit të gazit në Shqipëri me sistemin e ardhshëm të transmetimit të gazit në Kosovë, si dhe me linjat e degës lindore të Unazës së Gazit të Komunitetit të Energjisë. Korniza e investimeve të Ballkanit siguroi një grant prej 300 000 eurosh për studimin e para-fizibilitetit për projektin, i cili tashmë ka përfunduar. Nëse

ndërtohet, projekti do ta mundësojë gazifikimin e Shqipërisë dhe Kosovës dhe kështu do të sigurojë një furnizim me kostos të ulët dhe ndikim të ulët në mjetin e raport me drutë e zjarrit, qymyrin dhe vajrat e naftës. Pas vlerësimit të tregut të mundshëm të gazit në Kosovë dhe Shqipëri, u morën në konsideratë opsione të ndryshme të shtrirjes, duke përfshirë shtrirjen e rrjetit edhe ndërmjet Kosovës dhe vendeve fqinje. Zhvillimet e fundit në tregun e gazit në Evropë dë

ndërtimi i gazzjellësit TAP si korridor përfurnizimin me gaz nga Deti Kaspik në Evropë kanë krijuar kushtet përfutjen e gazit natyror në tregjet e energjisë të Kosovës dhe Shqipërisë. Për më tepër, tubacioni Jon-Adriatik (IAP) synon të krijojë një rrugë të re furnizimi përfurazh nga Lindja e Mesme dhe Deti Kaspik në veri, përgjatë bregdetit Adriatik. Ndërsa linja Shqipëri - Kosovë (ALKOGAP) do të ndërlidhet me këto dy tubacione të planifikuara të transmetimit të gazit që do t'i shërbjnë Shqipërisë./Monitor.al/



Më 28 gusht mbahet ankandi i dhjetë i letrave me vlerë

PRISHTINË, 20 GUSHT (ER) - Ministria e Financave (MF) ka njoftuar se më 28 gusht 2020 do të mbahet ankandi i dhjetë i letrave me vlerë përfshirë vitin 2020. Në këtë ankand do të emetohen obligacione me maturitet 3-vjeçar në shumën

prej 25 milionë euro. "Investimi në obligacione është investim i sigurt, i garantuar me Ligjin përfshirin publik, ku interes i përcaktuar nga tregu ju garantohet përf të gjithë kohëzgjatjen (3 vjet) dhe është

tërësisht i liruar nga tatimi. Për detaje rreth pjesëmarrjes në ankande përf blerjen e letrave me vlerë, ju lutem kontaktoni ndonjërrën nga bankat komerciale që operojnë në Republikën e Kosovës", ka njoftuar MF-ja.



ASK-ja: Gjatë muajit korrik në Kosovë u importuan mallra me vlerë 306.3 milionë euro

Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka bërë me dije se të dhënat nga tregtia e jashtme e mallrave në vendin tonë tregojnë për një deficit tregtar më të ulët për -11 për qind në muajin korrik 2020 në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2019. "Eksporti i mallrave në muajin korrik 2020 kishte vlerën 42.6 milionë euro, ndërsa importi 306.3 milionë euro, që është një rritje prej 5.4 përqindësh për eksport dhe një rënje prej (-9.1 përqindësh) për import, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2019", është thënë në raportin e ASK-së

**EPOKA
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 21 GUSHT - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar të premten të dhënat lidhur me rrjetet e eksportit dhe importit për muajin korrik 2020. Sipas ASK-së, të dhënat nga tregtia e jashtme e mallrave në Kosovë tregojnë për një deficit tregtar më të ulët për -11 për qind në muajin korrik 2020, në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2019, gjegjësisht në vlerë prej 263.7 milionë eurosh, krahasuar me deficitin prej 296.4 milionë eurosh sa ishte në vitin 2019.

Sipas ASK-së, eksporti mbulon importin me 13.9 për qind.

"Eksporti i mallrave në muajin korrik 2020 kishte vlerën 42.6 milionë euro, ndërsa importi 306.3 milionë euro, që është një rritje prej 5.4-përqindësh për eksport dhe një rënje prej (-9.1-përqindësh) për import, duke krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2019. Sipas të dhënavëve të grupeve kryesore të

eksportit: 32.6 për qind të eksporteve përbëhen nga metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 12.2 për qind të eksporteve përbëhen nga plastika, goma dhe artikujt prej tyre; 10.2 për qind të eksporteve përbëhen nga artikujt e ndryshëm të prodhuar; 9.8 për qind të eksporteve përbëhen nga ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 7.4 për qind të eksporteve përbëhen nga produktet bimore; 4.8 për qind të eksporteve përbëhen nga produktet minerale; 3.8 për qind të eksporteve përbëhen nga tekstili dhe artikujt prej tij etj.", është thënë në raportin e ASK-së.

Duke iu referuar këtij rapporti, sipas të dhënavëve të grupeve kryesore për import: 14.5 për qind e përbëjnë makineritë, pajisjet mekanike dhe elektrike; 12.5 për qind e përbëjnë ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 11.6 për qind e përbëjnë metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 10 për qind e



përbëjnë produktet minerale; 9 për qind e përbëjnë mjetet e transportit; 8.3 për qind e përbëjnë produktet e industrisë kimike; 6.9 për qind e përbëjnë plastika, goma dhe artikujt prej tyre etj. Ndërsa sa i përket eksportit të Kosovës me vendet e BE-së, sipas ASK-së, eksportet kanë arritur në 18.6 milionë euro, ose rreth 43.8 për qind e eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej 43.7-përqindësh. Partnerët kryesorë për eksportin e mallrave në BE janë: Italia me 12.4 për qind, Gjermania me 8.9 për qind, Austria me 6 për qind dhe Holanda me 3.8 për qind. Kurse, importet e Kosovës nga vendet e BE-së kanë qenë rreth 141.4 milionë euro, ose 46.2 për

qind e importeve të përgjithshme, me një rënje prej 13.3 për qind. Importet me pjesëmarrje më të lartë ishin nga: Gjermania me 13 për qind, Italia me 5.8 për qind, Greqia me 4 për qind, Polonia me 3.1 për qind, etj. "Në muajin korrik 2020, eksportet e Kosovës me vendet e CEFTA-s arritën në 17 milionë euro, ose 40 për qind të eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej 2.2 për qind. Partnerë kryesorë për eksport nga vendet e CEFTA-s janë: Shqipëria (17.5 për qind), Maqedonia (9.7 për qind), Serbia (8.9 për qind), dhe Mali i Zi (2.1 për qind). Ndërsa, importet nga vendet e CEFTA-s, në muajin korrik 2020, arritën në 65 milionë euro, ose 21.2 për

qind të importeve të përgjithshme, me një rritje prej 32 për qind. Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import ishin: Shqipëria (6.6 për qind), Maqedonia (6.3 për qind), dhe Serbia (6.2 për qind). Eksportet e Kosovës me vendet e tjera të botës arritën në 6.8 milionë Euro, ose 16.1 për qind. Si partnerë më të rëndësishëm nga këto vende për eksport vlen të përmendet Zvicra (7.8 për qind). Ndërsa, importet e Kosovës me vendet e tjera të botës arritën në 99.8 milionë euro, ose 32.6 për qind. Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import në këtë grup ishin: Turqia (13.2 për qind) dhe Kina (9.6 për qind)", është thënë në raportin e ASK-së.

Mustafa premton mbështetje për fermerët e Lipjanit



LIPJAN, 21 GUSHT (ER) - Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Besian Mustafa (MBPZhR), ka vazhduar vizitat në terren, për ta parë nga afër ecurinë e veprimitarive bujqësore të fermerëve. Kësaj radhe ai ka vizituar fermerët e Komunës së Lipjanit si dhe Parkun e Blinajës. Gjatë kësaj vizite ai ka qenë i shoqëruar nga kryetari i Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti, ku janë takuar me fermerët e kësaj komune, nga të cilët janë njoftuar përsfidat që po përballen ata gjatë kësaj periudhe. Me këtë rast, Mustafa është zotuar se do të jetë afër fermerëve.

"Mbështetjen përmes subvencioneve e kemi dyfishuar dhe do të jem vazhdimisht afër jush për t'ju përkrahur dhe motivuar përvizimtarive tuaja bujqësore, gjithnjë duke siguruar që të kemi ushqim cilësor përfamiljet tona", ka thënë Mustafa. Po ashtu, Mustafa ka vizituar parkun dhe vendgjetinë e Blinajës, një nga vendet e mbrojtura në Kosovë, ku ka shikuar edhe mundësitë përritjen e investimeve në këtë vend, në mënyrë që ky park të shndërrohet në një atraksion përvizita të ndryshme nga turizmi i organizuar.

Gjilani nis fushatën sensibilizuese ‘Vendose maskën, shpëto jetën’

GJILAN, 21 GUSHT (ER) - Komuna e Gjilanit, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, ka nisur të premtën aktivitetin “Vendose maskën, shpëto jetën”. Në këtë aktivitet janë të angazhuar të rinjtë e shkollave të mesme dhe organizatave të ndryshme joqeveritare për shpërndarje të maskave dhe për vetëdijesim të qytetarëve për masat mbrojtëse anti-Covid-19.

Nënqryetari i kësaj komune, Arbër Ismajli, ka falënderuar Policinë e Kosovës për angazhimin për vetëdijesim dhe këshilla për qytetarët për respektimin e masave mbrojtëse. “Ekipet e të rinjve që dalin sot në terren së

bashku me Policinë e Kosovës e bëjnë këtë për sensibilizimin e qytetarëve për përdorimin e masave mbrojtëse. Kjo mbetet mënyra e vetme e luftimit të pandemisë globale. Apelojmë që të vazhdohet respektimi i rekomandimeve të institucioneve të shtetit përbartjen e maskave, dezinfektuesve dhe ruajtjen e distancës sociale në mënyrë që sa më pak të rezultojnë raste me infeksion dhe sa më shpejt ta kalojmë këtë situatë”, ka thënë Ismajli.

Ndërsa major Alban Ramushi, komendant i Stacionit të Policisë në Gjilan, ka thënë se, bazuar në raportet e Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik të Kosovës, duhet të dimë se



virusi është shumë më afër se ajo që jemi duke menduar dhe përkëtë duhet një vetëdijesim i të gjithë qytetarëve duke mos e neglizhuar në asnje çast

infeksionin. Në këtë aktivitet ka folur edhe drejtoresha e DRKS-së, Deniza Limani, e cila ka njoftuar se në këtë aktivitet janë Këshilli i Nxënësve të Gjilanit,

Këshilli i Veprimit Rinor Lokal, organizata Fuqia e Bashkimit Rinor dhe organizata të tjera në mënyrë që sensibilizimi të jetë sa më i gjerë.



Nis asfaltimi i rrugës te lagjja e ‘Muhaxherëve’ në fshatin Qirez

SKENDERAJ, 21 GUSHT (ER) - Ka filluar asfaltimi i rrugës te lagjja e “Muhaxherëve” në fshatin Qirez të Komunës së Skenderajt. Punimet e kësaj rrugë nga afër i ka inspektojtar kryetari i kësaj komune, Bekim Jashari, së bashku me nënqryetarin Nuredin

Lushtaku, drejtoreshën e Urbanizmit, Sanije Ahmeti, drejtorin e Kulturës, Abdyl Ymeri, asamblistin Ilir Ejupi si dhe inxhinierët e këtij projekti rrugor. Gjatë këtij inspektojtar kryetari Jashari ka takuar edhe banorët e kësaj lagje të cilët edhe i ka uruar për

rrugën e re, rrugë e cila do ta ndihmojë qarkullimin me të lehtë të tyre. Kryetari Jashari ka theksuar edhe një herë se puna për përmirësimin e jetës së qytetarëve të Skenderajt do të vazhdojë me ritëm të lartë edhe në vijim.

Bahtiri rikthen vendimin që e diela të jetë ditë pushimi në Mitrovicë

MITROVICË, 21 GUSHT (ER) - Komuna e Mitrovicës ka bërë me dije se kryetari Agim Bahtiri ka vendosur që ta rikthejë vendimin që e diela të jetë ditë pushimi për mitrovicasit. “Pas shqyrtimit të kërkesave të pesëdhjetë e gjashtë bizneseve, për caktimin e ditës së diel ditë pushimi, ka njoftuar Komuna e Mitrovicës.

parasysh kërkesën e tyre si dhe gjendjen e krijuar si pasojë e pandemisë Covid-19, vendos për rikthimin e vendimit, që e diela të jetë ditë pushimi. Vërejtje: ky vendim hyn në fuqi, duke filluar nga diela e parë e këtij muaji, përkatësisht nga data 23.08.2020”, ka njoftuar Komuna e Mitrovicës.



Struzha e Prizrenit pritet të shndërrohet në fshat turistik

PRIZREN, 21 GUSHT (ER) - Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik në Prizren është duke planifikuar dhe analizuar mundësitet për fillimin e një pilotprojekti në fshatin Struzhë, i cili do të konsistojë në krijimin e mundësive të zhvillimit turistik dhe ekoturizmit.

Komuna e Prizrenit ka bërë me dije se parashihet të investohet

në rehabilitimin dhe vënien në funksion të një numri të shtëpive të vjetra të fshatit, të murosura me gurë natyralë, të cilat pastaj parashihet të shndërrohen në bujtina për turistët vendorë dhe ndërkombëtarë. “Si pikë e dytë e këtij projekti parashihet krijimi i një muzeu etnologjik, ku do të eksponohen eksponatet që janë



në dispozicion aktualisht në atë fshat dhe ato që mund të gjenden në vazhdimësi. Qëllim primar dhe kryesor i projektit është zhvillimi ekonomik i zonës në fjalë, zhvillimi i turizmit malor dhe pasurimi i ofertave turistike në kuadër të Komunës së Prizrenit”, ka njoftuar komuna e cila drejtohet nga Mytaher Haskuka.

SHQIPTARËT KURRË NUK E KANË DËMTUAR SERBINË, GJITHNJË KANË PËSUAR PREJ SAJ (33)



Shkruan: Kudusi LAMA

Pika 5 është vërtet shumë vulgare. Kufirin midis Shqipërisë e Kosovës e quani virtual, kur pas luftës në atë kufi janë vrrarë qindra qytetarë të të dyja anëve të kufirit, duke rënë në minat që ushtria serbe kishte lënë në kufi. Ju e quani kufi virtual pse kalonin të shpërngulurit shqiptarë prej Kosovës për në Shqipëri, por nuk thoni se ata po i përzente Serbia për të mos i lejuar të kthehen më kurrë dhe se kufiri ishte i lirë për të kaluar nga ana e Shqipërisë, por jo nga ana e Serbisë. Ndërsa prej datës 14 qershor 1999 e në vazhdim, kufiri nga Shqipëria dhe Kosova konsiderohej plotësisht i minuar. Ndërsa për kalim ishin pastruar vetëm pikat e kalimit në Morinë të Kukësit, në Qafë-Prush të Hasit, në Qafë-Morinë të Tropojës dhe një pikë kalimi ishte në Koshare të Tropojës, ku terreni kishte qenë i çliruar prej UÇK-së që në prill të vitit 1999. Gjithë vija tjetër e kufirit ishte shpallur e pakalueshme dhe për këtë me pjesëmarrje dhe financime ndërkombëtare është ndërmarrë një fushatë disavjeçare për ta pastruar dhe që personalisht mendoj se ende mund të ketë vende që nuk janë plotësisht të sigurta. Për t'ju kënaqur duhet t'ju them se vetëm në Morinë e Qafë-Prush edhe nëpër rrugëkalim të automjeteve, që të binin në mina qytetarët gjatë kthimit, ushtria serbe kishte instaluar 462 mina kundërtanke, të cilat UÇK-ja i zbuloi dhe i çminoi më 10-12 qershor. Por ti nuk ke dëshirë t'i dëgjosh këto se të prishin punë në misionin shumë kriminal që ke marrë mbi vete. Sikur të të kisha në atë kohë këtu zotëri e të të detyroja të futeshe në atë kufirin virtual, në të cilin "milicët e UÇK-së zhvendoseshin lirisht në të dyja anët e kufirit", e të ta shikoja fytyrën si do të bëhej. Fol zotëri fol, se të kanë dhënë një ulëse ku të ta shohin fytyrën sot në qendër të Evropës. Fol zotëri fol, se atdheun tënd ta ka çliruar Vilhem Tel. E këta Vilhelm Telat tanë ti po dëshiron t'i njolloshë. Kishit qenë edhe në Shqipëri në vitin 1999, dhe thoni se: "...unë vetë personalisht konstatova përmasën e gjerë të dukurisë; sidomos vura re solidaritetin e shquar të shfaqur nga popullsia dhe autoritetet shqiptare në pritjen e refugjatëve kosovarë".

Cila është përmasa e dukurisë zotëri? Pse nuk i vini emër dukurisë që keni konstatuar? Që kalohej në kufi nuk mund ta keni parë, se për këtë duhet të vinit tek unë, që isha komandant i asaj zone. Por ju keni parë "solidaritetin e shquar të shfaqur nga popullsia dhe autoritetet shqiptare në pritjen e refugjatëve kosovarë", siç thoni vetë. A edhe për këtë nuk keni ndier kënaqësi zotëri? Gjithë bota moderne e pati vlerësuar me notat më të larta këtë paraqitje shqiptare. Sa keq për ju zotëri!

Kur flisni në pikën 6, e quani të mbyllur çështjen e krimeve serbe. Ato qenkan zbuluar, dokumentuar, denoncuar dhe gjykuar. Duket sikur jepni një ultimatum, për të mos u marrë më me serbët dhe Serbinë e krimet e kryera mbi shqiptarët. Dhe duket sikur tashmë e keni gjetur edhe Milosheviçin, i cili duket sikur paska ardhur vetë në Kosovë dhe i paska vrrarë shqiptarët e nuk paska fajtorë të tjerë. Jo zotëri, të gjithë kriminelët do të jepin llogari deri në fund, për çdo pikë gjak do të jepet llogari. Mos mendoni se është mbyllur kjo çështje. Shqiptarët nuk do të ndalen kurrë derisa të zbardhin gjithçka. Doni a nuk doni ju bashkë me miqtë e serbëve e të Serbisë. Fqinjësi me Serbinë shqiptarët do të kenë, ndoshta edhe fqinjësi të mirë, por miqësi me Serbinë as që duhet të mendojnë, të paktën edhe për një shekull. Miqësia ka disa parametra, që Serbia as i ka plotësuar ndonjëherë, as i plotëson, as ka për t'i plotësuar në marrëdhëniet me shqiptarët. Miqësitë nuk bëhen me parulla, zotëri. Shqiptarët kurrë nuk e kanë dëmtuar Serbinë, gjithnjë kanë pësuar prej saj në gjithë rrugën historike të derisotme. Kur Serbia t'i jepë provat e miqësise, shqiptarët do të dinë ta vlerësojnë. Por ju nuk na diktoni dot miqësi me Serbinë që, sipas jush, u realizuaka duke na përbaltur historinë e duke na quajtur të pacivilizuar.

Me thënë të drejtën, zotëri Marty, duke lexuar raportin tuaj, mua më krijohet ideja se ju nuk jeni duke folur për shqiptarët e trevat e tyre, më duket sikur jeni duke folur për një shoqëri që realisht unë nuk e njoh, nuk di a mos keni kopjuar ndonjë material para 300-vjeçar, të gjetur ndokund. Zotëri, të them sinqerisht, po të isha unë kontrollor i raportit tënd, më duket kaq i vjetruar sa do t'ju kisha nxjerrë jashtë me gjithë raport. Ju gjithçka e keni shkruar duke paragjykuar. Në pikën 7 ju gjykon strukturat ndërkombëtare që, për hir të vendosjes së stabilitetit, paskan

lënë pa ndëshkuar krimet të shumta, të cilat, siç duket, janë të pranishme vetëm në kokën tuaj zotëri. Por ju arritet me raportin tuaj ta bindni edhe Këshillin e Evropës se në Kosovë ka ndodhur shumëkëa kriminale dhe që ju keni përcaktuar edhe kriminelët, të cilët, sipas jush, janë drejtuesit e lartë të UÇK-së. Ju akuzoni edhe NATO-n, pse duke goditur Serbinë nga ajri, bëri që "UÇK-ja u bë në këtë mënyrë aleati i tyre i domosdoshëm për veprimet tokësore". Sepse gjithnjë, sipas jush, u "parapëlqye kështu të mylleshin sytë ndaj krimave të luftës të bëra nga kjo e fundit". Këto qëndrime e vlerësimë realisht nuk i kemi dëgjuar prej askujt para jush, përvèç prej serbëve, të cilët unë jam i bindur se kanë përgatitur edhe raportin tuaj dhe për këtë në këtë shpjegim gradualisht do të përpinqem t'i sjell të gjitha faktet dhe arsyetimet që njoh unë për këtë çështje, duke i krahasuar termat tuaja dhe arsyetimet tuaja me ato serbe jo vetëm tani, por në vazhdimesi.

Ju keni guxim, ju nuk përtoni ta akuzoni edhe administratën e OKB-së dhe ShBA-të, duke u shprehur se: "Administratat ndërkombëtare që pasuan njëratjetërin në vend, si dhe administrata amerikane që, sipas mendimit të përgjithshëm, luan një rol të madh në mbarëvajtjen e çështjeve të entitetit të ri në Kosovë (Shtetet e Bashkuara kanë një ambasadë që disponon mjete nga më të fuqishmet, si dhe një bazë ushtarake, Kampi Bonstill, rëndësia e së cilës shkon shumë më përtëj përmasës krahinore), u bënë pra njësh me aleatët e tyre faktikë në terren, të cilët ishin bërë tashmë zotëruesit e rinj të politikës lokale". Por në gjithë këtë ligjëratë, ju bëni disa gabime të rëndësishme. Kosova tashmë është shtet dhe mund të bashkëpunojë me çdo shtet që e vlerëson me interes, ndërsa ju akoma me mendësitë e Titos e Milosheviçit e emërtioni krahinë, kurrë ajo s'ka për të qenë më krahinë e Serbisë, zotëri Marty. Ashtu edhe shtetin e Kosovës dy vjet pas shpalljes së pavarësisë ju e quani qeverisje lokale. Mos bëni kështu gabime. Mësuhuni t'i emërtoni gjérat siç janë në të vërtetë, jo siç do të kishit ju dëshirë të emërtosheshin. Shqiptarët në Kosovë nuk do të janë më kurrë vetëm zotëruesit e qeverisjes lokale, por të të gjithë qeverisjes së vendit duke punuar për ta zhvilluar atë vend sipas standardeve të kohës. Ju zotëri i quani shqiptarët kaq të kriminalizuar sa nuk mund t'i besohet as edhe një përkthyesi shqiptar, pasi ai ua përcjell

informatat të interesuarve. Besoj se ju gjatë punës tuaj në vendin e shqiptarëve, patjetër duhet ta keni pasur përkthyesin serb. Mirë keni bërë, se vetëm me përkthyes të tillë mund të bënë këtë raport, çfarë e keni bërë, në qoftë se e keni bërë, pasi unë jam i bindur se e keni marrë të gatshëm.

Në pikën 8, ju shpreheni: "Cështja e Nazim Bllacës, 'dhënësit të alarmit', që publikisht u vetëakuzua përvrasje të komanduara nga persona që sot janë të veshur me përgjegjësi të larta politike, është emblematike". Po mirë, le të mendojmë për një çast se te ky Bllaca e zbuluat krimin, çfarë duhet të kuptojmë me termin "emblematike" në një raport për Këshillin e Evropës? Megjithatë, unë jam i bindur se edhe Bllaca është i rekrutuar i juaj, ashtu siç keni rekrutuar edhe ata që i quani dëshmitarë të fshehtë. Zotëri, krimet zbulohen me fakte, jo me rekrutë e dëshmi prapa perdes. Askënd nuk mund të akuzosh pa e vënë para fakteve, pasi në të kundërt duhet ta zini vendin e tij.

Në pikën 9 thoni: "Përpjekjet po fillojnë të jepin rezultate të dukshme, konkretisht për sa iu përket dosjeve të kampit të Kukësit dhe të klinikës 'Medicus' në Prishtinë". Dhe unë të uroj t'i zbulosh të gjitha krimet nëse kanë ndodhur, por nuk pajtohem me bashkimin që i bën të ashtuquajturit kamp të Kukësit me klinikën Medikus në Prishtinë. Midis këtyre dy institucioneve jam plotësish i bindur se nuk ka asnjë lidhje. Mos harroni zotëri se Kukësi në pranverën e vitit 1999 nuk ka pasur një kamp, por ka qenë i gjithi kamp, pasi në një qytet me 20 mijë banorë kanë jetuar provizorish rrëth 700 mijë të shpërndarur dhe deri në fund të luftës 120 mijë të shpërndarur. Brenda këtij kampi të madh ka qenë edhe ajo qendër grumbullimi dhe qendër operacionale shumë e lavdishme dhe shumë efektive, që ju e quani "kampi i Kukësit". Vetëm atë punë që pretendoni ju, ajo qendër nuk e ka bërë. Ndërsa kur të flisni për klinikën "Medikus" në Prishtinë mund të thoni çfarë të doni nëse ka bërë krim, ajo nuk i përket Luftës Çlirimtare të Kosovës. Lufta është bërë për liri, ndërsa klinika është ngritur përbiznes. Janë shumë larg me njëra-tjetër. Nëse i bashkojmë këto dy institucione në një, kemi të bëjmë me një veprëtari të dyshimtë dhe dashakeqësi të qëllimit. Por, në fund të fundit, ju mund të shkruani si të doni, pasi keni një synim të caktuar, të cilin edhe e keni realizuar dhe besoj jeni shpërblyer.

Me thënë të drejtën, zotëri Marty, ju nuk hiqni dorë nga shkatë. Në pikën 13 të raportit tuaj shkruani: "Shumë familje kosovare shqiptare që kanë humbur një të afërt të tyre pas 12 qershorit 1999, do të kenë shpallur një datë zhdukjeje përpëra kësaj date, nga frika se mos të afërmët e tyre cilësohen si 'tradhtarë' të ndëshkuar nga UÇK-ja". Pyete more edhe shqiptarin më të paditur, a bëhet dot një gjë e tillë ndër shqiptarët, se do të të japë përgjigje të prerë: Kurrë. Mos bëni more shaka me fjalë të tillë të pamoralshme, se nuk është mirë edhe për ju e për organizatën së cilës i përkisni. Nuk jetohet në shkretëtirë këtej nga shqiptarët zotëri, këtu jetojnë njerëz shumë të përgjegjshëm, qytetarë të kulturuar dhe që e besojnë Zotin. A e besoni ju vërtet Zotin? Si u dhënka data e zhdukjes së personit si të dojë njëri e tjeter? Askush more zotëri ndër shqiptarët nuk ka frikë askënd, për një vepër që nuk e ka kryer. Tek ne tradhtarët nuk shpallen në tyn, ata historikisht janë shpallur publikisht nëse kanë konsumuar aktin e tradhtisë kombëtare e ndaj atdheut me fakte e me dëshmitarë, veç jo si ata dëshmitarë pas perdes e pa emër që kërkoni ju, por dëshmitarë me emër e mbiemr. Duke iu referuar datës 12 qershor 1999, që është shpallur si ditë e çlirimtë të Kosovës, megjithëse ushtria dhe policia serbe janë larguar përfundimisht nga Kosova më 22 qershor 1999, ju bëni shumë lojëra fjalësh përtakuar Ushterinë Çlirimtare dhe drejtuesit e saj. Ju shtireni sikur nuk e dini se ka ligje të njohura botërisht përshtypen e të zhdukurve, pasi ata nuk mund të shpallen me vullnet politike. Shqiptarët edhe sot kanë rrëth 2000 të zhdukur, të cilëve nuk u dihet fati dhe nuk mund të ndërmerr vendime për t'i trajtuar. Pasi të zhdukurit nuk mund të trajtohen pa adresë. Ashtu edhe fakti që edhe sot ka ende familje që nuk dëshirojnë t'i shpallin të zhdukur familjarët e tyre, me shpresë se mund të janë gjallë diku. Këtu nuk ka pasur asnjëherë gjuesti njerëzish por ju, siç duket, keni lexuar shumë përiudhën e zbulimit të Amerikës, kur evropianët organizonin dëbenin gjuetinë e indianëve, për ta pastruar terrenin prej tyre e për ta shfrytëzuar përvete. Të jeni i sigurt se atë lloj gjuetie e ka bërë Serbia në trojet shqiptare të pushtuar, përfshirë Kosovën prej një shekulli, ani pse nuk arriti t'i zhdukë shqiptarët. (Vijon)

Akad. Prof. dr. Edmond Pinguli vlerëson lartë krijimtarinë shkencore të Prof. dr. Eqrem Zenelajt

HISTORI MONUMENTALE



AKADEMIK EDMOND
NASI KONSTANTIN
PINGULI

PROF. DR. JU. EQREM ZENELAJT
Ju lutem të pranoni konsiderat e mia më të mira, më të larta dhe më dinjitoze për veprimtarinë tuaj të shquar, të arrirë dhe të dobishme në fushën e historisë së lashtë, ekzistencës dhe të zgjimit të identitetit të kombit tonë. Kjo gjë ju jep Juve të drejtën e pakundërshtueshme të një dijetari me vlera të larta tekniko-shkencore të patjetër-sueshme si edhe të një luftëtarit trim dhe guximtar në mbrojtje të parimeve të larta dhe sublime që një atdhetar i devot-shëm mund të arrije gjatë jetës së tij të shprehë kaq qartë me siguri, krenari, forcë dhe dituri dashurinë për mëmëdheun e tij.

Nuk është e rastit, që kombi ynë gjatë historisë së lashtë ka nxjerrë njerëz të tillë, të cilët në mbrojtje të kauzës së ekzistencës, i kanë dalë me madhështinë e intelektit dhe punës së tyre të ndritur, për zot atij. Kjo është parë dhe ndjerë në çdo moment të rrezikshëm gjatë rrugës së gjatë të mbi-jetës së tij. Të lumtur janë ata bij, që dhanë gjithçka me dinjitet për kauzën e drejtë në shërbim të mbrojtjes dhe mirëqenies së popullit tonë. Ata do të mbeten gjithmonë, si një "HISTORI MONUMENTALE" e gjallë dhe e papërsërithme e potencialit energjistik të ciliruar nga mendja e atdhetarëve tanë. Njëkohësisht, kjo do të jetë një "BUSULL" e saktë orientimi për të gjithë ne në aspektin, se si duhet të ndërtojmë "Shoqërinë Kombëtare Moderne", e cila të qëndrojë me dinjitet në familjen e madhe evropiane, si një vend i lashtë i bukur dhe i begatë i këtij kontinenti.

"Lypsin nuk e do njeri, atë të gjithë e mëshirojnë".

Me këto vepra të shkruara mund të mburret çdo shqiptar brenda dhe jashtë trevave kombëtare në arenën ndërkombëtare. Pra, duhet ta kujtojmë, t'i bëjmë homazh dhe t'i përkulemi me nderim të thellë asaj pune të lavdishme, lufte të paepur si edhe të papërsërithme, sa historike dhe teknikoshkencore, të kryer nga studi-

uesit tanë. "HEGEL" thoshte se: "Intelektual i vërtetë është ai, që i përkushtohet Kombit të vet".

Me të drejtë mund të theksojmë, se duhet të zgjohemi nga gjumi letargjik, që na ka mbërthyer historiografia politike shabllone dhe pa kurrfarë mbështetje shkencore dinjitoze. Por t'i kthehem i me shumë përkushtim, krenari dhe ndjenjë kombëtare rishikimit, si edhe implementimit të studimeve shkencore përgjenezen e vërtetë të "Kombit dhe Popullit Shqiptar". Nga gjiri i këtij populli kanë dalë dhe do të dalin të gjithë ata studiues, që kontribuan dhe do të vazhdojnë me punën e tyre të palodhur dhe shumë të vështirë, për të bërë realitet këtë projekt gjigand, i cili do t'i japë dritën e syve "Mëmëdheut", si edhe rrezen e dritës që ne do të shijojmë në të ardhmen në jetë të jetëve, pa të cilën ne do të jemi në mënyrë sinjifikative tek "KANDILI, si KOMB".

Ata, ne duhet t'i kujtojmë me respekt dhe krenari të thellë dhe sublime pa përjashtim si edhe ngjyrim politik, përkushtim, vendosmérinë, kompetencën profesionale si edhe dashurinë e pafundme për lumturinë, begatinë, mirëqenien e popullit dhe zhvillimin e atdheut, punuan dhe sakrifikan përkëtë qëllim fisnik. Ata luftuan për një ideal të lartë dhe dhanë gjithçka si edhe do të jepin në të ardhmen përkëtë qëllim fisnik. VIKTOR HYGO thoshte se: "Kushti i domosdoshëm për të qenë i lumtur është PUNA". Jeta e njeriut i përket atdheut të tij dhe ajo në çdo moment duhet të jetë e domosdoshme dhe e vlefshme për të. Për çdo njeri gjatë verimtarisë së tij të jetës, duhet të jetë i shtrenjtë trinomi: "DETÝRA, NDERI, ATDHEU".

Njeriu duhet të jetë gjithmonë një bir besnik i atdheut të tij, duke merituar vlerësimin më të madh të "Shoqërisë Shqiptare". Tek ata buron shpirti fisnik dhe krenar i "Shqiptarit", qëndresa historike e luftëtarëve dhe pastërtia shpirtërore e njerëzve të ndershëm, të cilët dhanë gjithçka, që ju kërkua dhe nuk morën asgjë. Po ashtu, dashuria e pafundme për atdheun dhe punën, ishte baza e

emrit të tyre dinjitoz si intelektualë të mirëfilltë dhe të vërtetë. ABRAHAM LINKOLNI thoshte se: "Krenaria e një populli fillon tek kopështi i fëmijëve dhe përfundon tek azili i pleqëve".

Të gjithë duhet t'i kujtojmë këta studiues me dashuri, respekt dhe nderim të madh këta "HERONJ TË HESHTUR", sepse në asnjë vend nuk është shkruar për ta, ose të janë kujtuar, duke i marrë si shembull në të gjithë veprimtarinë e tyre. Ata do të mbeten gjithmonë modelet e skalitura të gjalla, tek të cilët ne duhet të shohim sot me skepticizëm veten tonë në pasqyrë, deri sa të kemi frymën e fundit. Nderimi për punën dhe jetën e secilit, bën kështu gurin e çmuar të veprimtarisë njerëzore. Mirënjojha e thellë ndaj një kujtimi përmban në vvetetë, obligimin më dinjitoz, që shpreh në veprimtarinë e saj një shoqëri e emanciuar. HORACI thoshte se: "Është kënaqësi dhe nderi të vdeshë për atdheun, por edhe më kënaqësi është të jetosh për

të".

Historikisht ky popull i lashtë i Komunitetit Evropian, ka nxjerrë figura të shquara të cilët me veprat dhe punët e tyre, kanë treguar, se ky vend ka dhe do të ketë gjithmonë përfaqësues të denjë, përpotencialin e tyre mendor dhe forcën shpirtërore, të vlerësuar në nivelet më të larta, të prodhimit gjenerues të racës njerëzore. Ata janë dhe do të mbeten një shembull klasik me përmasa reale të veprimtarisë njerëzore, të cilët shërbjen me përkushtim në periudha të ndryshme, të vështira dhe të rëndësishme të zhvillimit historik tonin. Kjo do t'u tregojë të gjithëve në çdo periudhë kohore, se çfarë punë e madhe, vëtmohuese dhe e vështirë është kryer në kohë. Dikush me të drejtë ka shprehur sentencën se:

"Kush mohon të kaluarën, nuk ka të ardhme, kush mohon traditën nuk ka histori dhe kush nuk ka histori, nuk mund të quhet popull".


Me kënaqësi e shkruajta këtë

"Promemorje", i ndikuar nga puna dhe arritjet tuaja të veprimtarisë shkencore historike në shërbim të njohjes së thellë të gjenezës së "Kombit Shqiptar". Njëkohësisht jam shumë i impresionuar nga literatura e përdorur në librin tuaj të cilin unë nuk e kam lexuar por e kam zbërthyer me shumë kënaqësi, duke e krahasuar me qindra libra që unë disponoj që nga viti 1790.

Mora vesh, se po e botoni edhe një herë me plotësimë të reja, të cilat do t'i shtojnë akoma më vlera veprës tuaj, e cila do të mbetet si një "BIBËL E SHENJTË" për ne Shqiptarët. Ajo do të mbetet në arkivin shkencor-historik të librave fondamentale të "Gjenezës Originale të Kombit".

Edhe një herë ju uroj shëndet, mirësi, punë të mbarë dhe suksesë të mëtejshme në rrugën tuaj të ndritur në shërbim të së vërtetës të pamohueshme të historisë tonë të lashtë dhe që meriton vendin e nderit në historinë botërore.

17.08.2020





ROYAL CROWN
RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
- ★ Fludi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1905
0.5L

The advertisement features a dark blue background with a yellow banner for the awards. Below the banner, a list of award recipients is presented in a dark blue box. To the right, there are images of a blue RC Cola can and a dark plastic bottle of RC Cola on a wooden surface.

Errallë

Gjermania pritet ta bëjë të detyrueshme shëtitjen e qenve

Të shkosh në shëtitje me një qen dy herë në javë për një orë mund të bëhet i detyrueshëm me ligj nga viti i ardhshëm në Gjermani. Kjo mund të bëhet gjithashtu e obligueshme për të mos pasur të drejtë për ta lidhur qenin për një periudhë të gjatë. "Kafshët shtëpiake nuk janë lodra të mbushura, nevojat e tyre duhet të merren parasysh", ka thënë ministria e Bujqësisë, Julia Klöckner, në lidhje me ndryshimet e planifikuar. Sipas rregullave të reja, pronarët e qenve kanë këto



detyrime: ta dërgojnë kafshën shtëpiake për shëtitje dy herë në ditë për të pak-

tën një orë dhe qeni nuk duhet të qëndrojë vetëm gjithë ditën.

FOTO E DITES



Pamje nga pelegrinazhi në malin e Tomorrit, i cili konsiderohet "i shenjtë" pasi në të prehet shenjtori i familjes së profetit Muhammed, Abaz Aliu. /LSA/



DASHI
Hëna do të sjellë ndikim negativ në shenjën tuaj duke ju sjellë ndonjë problem në dashuri ose në sferën personale.



DEMI
Duhet të pushoni në shumë. Sa i takon punës, mund ta takoni dikë i cili do t'ju japë udhëzimet e duhura për të ardhmen.



BINJAKËT
Mëngjesi do të nisë nën ritmin e duhur, por gjatë pasdites do të ketë përmirësim. Mundohuni që të mos përfshiheni në polemika, sidomos në mëngjes.



GAFORRJA
Duhet të mundo-heni që t'i shmangni debatet dhe polemikat. Kjo fundjavë do të jetë e mbushur me nervozizëm për shkak të ndikimit të kundërt të hënës.



LUANI
Mos kini frikë të ndryshoni, nëse situa-ta në të cilën ndodheni, nuk ju bën që të ndiheni mirë. Në punë do të synoni sa më lart, sidomos nëse keni ide krijuese.



VIRGJËRESHA
Ndonjë komplikim do të shfaqet i mbartur nga muajt e kaluar. Në punë, kjo është një periudhë e mbushur me zgjedhje të mëdha.



PESHORJA
Mundohuni që të keni më shumë besim në vete. Në dashuri, duhet të mundoheni që të rikuperoni një raport apo të sqaroni një keqkuptim.



AKREPI
Në dashuri çiftet e qëndrueshme mund të rrinë të qetë, ndërsa kujdes duhet të tregojnë ata që janë lidhur së fundmi.



SHIGJETARI
Mundohuni që t'i shmangni debatet në dashuri, sidomos në mëngjes. Gjatë pasdites situata do të përmirësohet.



BRICJAPI
Sfera sentimentale paraqitet mjaft e favorshme gjatë kësaj të premte. Ata që janë vetëm do të kenë mundësi që të bëjnë takime të reja.



UJORI
Pranoni ftesat, dilni dhe njihni njerëz të rinj, pasi mund të ndodhin gjëra të bukura. Kujdes duhet të tregoni me financat.



PESHQIT
Mëngjesi do të nisë nën ritmin e duhur, por gjatë pasdites situata do të përmirësohet. Mundohuni të mos ndikoheni nga të tjerët.

BARSOLETA E DITËS




Dy shokët

- Që kur jam shkurorëzuar nuk po e bëj më gjumin rehat.
- Aq shumë të mungon gruaja?
- More burrë, ma mori krevatin se!



Në Kino ABC nuk ka shfaqje



E jashtëzakonshme

Studimi: Në 100 mijë planetë ka forma jete

Është krijuar një instrument i ri që do të ndihmojë në gjetjen e jetës në trupa qiellore të tjerë në galaktikën tonë. Në bazë të sinjaleve që kapen e dallohen në atmosferën e planetave të tjerë, astronomët përdorin teknikën e spektroskopisë, që konsiston në analizimin e shpërshdarjes së dritës. Në këtë fazë mbidhen të dhëna interesante e të rëndësishme mbi gazrat që janë pjesë e kalkulimeve, pasi janë tregues të gjurmëve biologjike. Dhe pikërisht këto gjurmë janë baza e

mënyrës së studimit statistikor që do të realizojë modeli i ri. Sipas ekspertëve, nëse supozohet që jeta mund të lindë në çdo planet, pavarësisht prej kushteve dhe rrëthanave të tjera, studimi në fjalë tregon se nëse metoda e re gjen një gjurmë biologjike atëherë, sipas kalkulimeve matematikore, rezulton se në "Rrugën e Qumëshit" mund të ketë jetë në 100 mijë planetë. Studiuosit specifikojnë se bëhet fjalë për forma jete dhe jo domosdoshmërisht për civilizime alienë.

Zaimina vazhdon т  provokoj  buz  bregdetit



Këngëtarja e njohur shqiptare Zaimina Vasjari është rikthyer me projektin e ri muzikor, pas një pauze të gjatë në skenë. Kënga “Vetes” ishte e mirëpritur nga publiku, andaj Zaimina edhe i ka falënderuar publikisht për

mbështetjen pas rikthimit. Ajo këtë sukses po e shijon derisa po argëtohet me familjen në bregdet. Zaimina nuk po i ndalon pozat provokuese dhe format trupore i ka treguar edhe në imazhet e fundit ku shfaqet në bikini.

Tuna reklamon linjat trupore



Këngëtarja Tuna Sejdiu ka postuar një fotografji në llogarinë e vet në "Instagram", ku shfaqet në biki duke i kaluar pushimet. Tuna duket mjaft seksi në këtë fotografji, por edhe në të tjerat. Ajo u kushton rëndësi fotografive që poston në

rrjete sociale të cilat ua dhuron fansave. Këngëtarja ka kohë që nuk është aktive në skenën muzikore, por atë e gjeni aktive në rrjete sociale. Aktualisht nuk dihet se ku Tuna po i kalon pushimet verore, megjithatë vendi duket mjaft tropikal.




Tayna “harron” të vesh të brendshme

Reperja e njohur shqiptare Tayna nuk është duke ndaluar së punuari për këngë të reja. Gjatë xhirimit të klipit të fundit ajo ka publikuar pamje të ndryshme dhe ajo më e komentuara ka qenë e veshur me fustanin e kuq.


Repartistja ka marrë vëmendjen pasi shihet se nuk ka veshur fare të brendshme. Fustani i ka zbuluar gjithçka dhe mund ta vini re në këto fotografi. Fotot janë shkëputur nga projekti i saj i ri muzikor, kënga “Qe qe”.

Provokon Kim Kardashian



Kim Kardashian është një prej emrave më të komentuar në media. Raportet me bashkëshortin e saj Kanye West kanë qenë vetëm disa nga arsyet, ndërsa Kimi vazhdon ta marrë vëmendjen edhe me pozat provokuese. Së

fundmi e ka publikuar një foto në të cilën ka vënë në fokus të veçantë format e përkryera trupore. Kimi njihet për trupin sekzi, madje shpeshherë thuhet se është konkurrentja më e fortë e shumë vajzave.



Drejtuesit e FBK-së kërkojnë përkrahje nga MKRS-ja

“Me ministren Dumoshi kemi diskutuar për problemet me të cilat po ballafaqohemi në këtë kohë pandemie ne si komunitet i basketbollit dhe për gjetjen e mënyrës më të duhur për përkrahje të klubeve dhe basketbollistëve/eve tona në këto kohë të vështira nga pakoja emergjente e Qeverisë së Republikës së Kosovës”, ka thënë Arben Fetahu, kryetar i FBK-së.

PRISHTINË, 21 GUSHT - Drejtuesit e Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), kryetari Arben Fetahu dhe sekretarja e përgjithshme, Elvira Dushku, e kanë pasur një javë të ngjeshur sa iu përket takimeve me zyrtarë të lartë të sportit, ku janë diskutuar tema të ndryshme e që lidhen me sportin përballë pandemisë, më saktësisht basketbollin përballë pandemisë.

Kryetari Fetahu dhe sekretarja e përgjithshme Dushku janë pritur në një takim pune nga Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport, Vlora Dumoshi, si dhe nga ushtruesi i detyrës i sekretariatit të përgjithshëm në MKRS, Ibër Alaj. Tri temat kanë kryesore që janë ngritur si çështje më urgjente nga numri një i FBK-së, Arben

Fetahu: ndihma nga pakoja emergjente e Qeverisë për klubet tona, për basketbollistët, fillimi i garave të basketbollit dhe themelimi i Ligës Unike të Basketbollit. “Me ministren Dumoshi kemi diskutuar për problemet me të cilat po ballafaqohemi në këtë kohë pandemie ne si komunitet i basketbollit dhe për gjetjen e mënyrës më të duhur për përkrahje të klubeve dhe basketbollistëve/eve tona në këto kohë të vështira nga pakoja emergjente e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Ne e theksuam faktin se është e rendësishëm për ne si Federatë që komuniteti ynë ta ndiejë përkrahjen nga qeveria dhe nga vetë federata, sepse ne gjithnjë e theksojmë faktin se



sportistët dhe sporti janë ambasadorët më të mirë të një shteti, andaj në këto kohë të vështira ne duhet të qëndrojmë përkrahë tyre dhe të dëshmojmë se ata janë gjithnjë të rëndësishëm për ne dhe jo vetëm atëherë kur arrijnë rezultate kulmore. Ministria Dumoshi e kuptoi mjaft mirë situatën e FBK-së karshi klubeve dhe basketbollistëve/eve dhe premtoi se në një kohë shumë të shkurtër do të formohet një grup punues për ta çuar procesin përparrë”, ka thënë Fetahu, i cili

ka vlerësuar bashkëpunimin me MKRS-në për mbështetjen e projekteve të federatës, duke përfshirë ato të basketbollit dhe basketbollit 3x3. “Biseduam edhe përmundësinë e fillimit të garave të FBK-së me kalendarin e planifikuar, pra nga java e dytë e shtatorit kur edhe është në program të organizohet Superkupa e Kosovës, por përkëtë duhet pritur deri të hënën për ta shikuar mundësinë se a mund të fillojmë me kohë apo duhet ta shtyjmë fillimin e garave. Po ashtu, ministria tha se

në koordinim me autoritetet përgjegjëse shtetërore, do të angazhohet që sa më shpejt që është e mundur të lejohet nisja e garave për edicionin e ri në basketboll. Gjithsesi, bordi i FBK-së të hënën më së largu do të marrë vendim për shtyrjen apo jo të fillimit të garave të FBK-së”, ka shtuar ai. Ndërsa sekretarja e përgjithshme e FBK-së, Elvira Dushku, ka bërë me dije se ministria Dumoshi i ka dhënë FBK-së përkrahje për krijimin e Ligës Unike të Basketbollit.

Vëllaznimi humbet investitorin gjerman për shkak të Covidit

GJAKOVË, 21 GUSHT - Pandemia Covid-19 ka bërë që skuadra e Vëllaznitit nga Gjakova të humbasë një investitor nga Gjermania. Për këtë dështim ka njoftuar kjo skuadër në llogarinë zyrtare në “Facebook”. “Klubi është në gjendje jo të mirë financiare dhe me lojtarë. Gjermani Franck Gerber ishte i interesuar ta privatizojë klubin qysh në muajin prill, edhe pse nuk pati asnjë problem as nga klubi e as nga Kuvendi Komunal. Por, u ndërpërshtaku i pandemisë dhe derisa të përfundojë pandemia. Pasi të kalojë kjo gjendje do t'i vazhdojmë bisedimet për privatizim. Pandemia Covid-19 nuk dihet se sa do të zgjasë. Ne si klub nuk mund të rrimë duar kryq sepse jemi shumë mbrapa me lojtarë me organizim dhe stërvitje”, thuhet në njoftimin e klubit kuqezi. “Pas deklaratës së dhënë nga përfaqësuesi i Franck Gerber, Nikoll Paloka, që nuk



mund të udhëtojnë për në Kosovë shkaku i pandemisë, menjëherë është lajmëruar ish-kryetari Shkëlzen Gashi. Edhe pse është në Gjermani, ka shprehur dëshirën që edhe një herë ta ndihmoj klubin për të mos e lënë në këtë gjendje dhe ka theksuar se duhet shumë shpejt për organizohemi të marrim lojtarë që të paktën për

sezonin vjeshtor të jemi të përgatitur mirë, e në pranverë të organizohemi shumë më mirë. Shkëlzen Gashi ka theksuar se nuk do të jemi pengesë e askujt, për ata që dëshirojnë ta ndihmojnë klubin dhe për ata që dëshirojnë ta privatizojnë mund ta bëjnë në çdo kohë”, thuhet në njoftimin e klubit kuqezi.

Prishtina kryen testet për Covid-19 në Gjibraltar, sot përballet me Lincolnin

Prishtinë, 21 gusht - Fituesja e Kupës së Kosovës në futboll, FC Prishtina, ka shkuar në Gjibraltar për herë të dytë brenda pak ditësh për ta zhvilluar ndeshjen parakualifikuese për Ligën e Evropës ndaj Lincoln Red Imps. Kujtojmë se Prishtina do ta luajë sot (e shtunë) ndeshjen e Ligës së Evropës

ndaj Lincoln Red Imps në kuadër të Ligës së Evropës, në rast se të gjithë futbollistët e grumbulluar rezultojnë negativë në testin për koronavirus. Para pak ditësh kjo ndeshje është shtyrë për të shtunën pasi tetë lojtarë të Prishtinës rezultuan pozitivë. Ndeshja është e paraparë të zhvillohet nga ora 18:00.



Mick Schumacher shihet si zëvendësues i Vettelit te Ferrari

MARANELLO, 21 GUSHT - Mick Schumacher, djali i shtatë herë kampionit të botës në Formula 1, Michael Schumacher, mund ta zërë vendin e Sebastian Vettelit te Ferrari në Formula 1. Për momentin kjo është vetëm një ide, por gjithçka mund të

ndodhë këtë sezoni, duke parë paraqitjet e dobëta të gjermanit me "kokëkuqen". Mick, 20 vjeç, aktualisht garon në Formula 2 me makinën Prema, ndërkohë që është pjesë e Akademisë Ferrari. Mattia Binotto, drejtori sportiv i Ferrarit, ka deklaru-

ar: "Mick në Formula 1? Është ende herët për ta diskutuar këtë çështje. Për momentin duhet të mendojë për sezonin aktual në Formula 2. Mick po paraqitet mirë. Kishte objektiv përmirësimin dhe ka arritur rezultate të mira. Për sa i përket të ardhmes së tij, do të

flasim me të se çfarë do të bëjë sezonin e ardhshëm. Mendoj se është më logjike që ta nisë rrugëtimin në Formula 1 me një makinë më të vogël, në mënyrë që të ambientohet me këto njëvendëshe", ka thënë Binotto.



Licencohet Federata e Pikados e Kosovës

PRISHTINË, 21 GUSHT - Sportit të Kosovës i shtohet edhe një federatë. Nga sot zyrtarisht do të ketë të drejtë ta zhvillojë veprimtarinë e vet Federata e Pikados e Kosovës. Me këtë rast, ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi, i ndau licencën kryetarit të kësaj federate, Arben Sllovinja.

Ministrja Dumoshi vlerësoi se sporti i pikados është një aktivitet sa zbavitës aq edhe atraktiv, e që ata që janë të apasionuar pas këtij sporti, prej sot kanë një organizatë sportive e cila i përfaqëson dhe i organizon. "Themelimi i Federatës së Pikados dhe licencimi i saj e pasuron sportin e Kosovës duke e shtuar numrin e organizatave sportive që operojnë në vendin tonë dhe ne si ministri jemi tejet të lumtur që ka të interesuar që ta promovojnë, zhvillojnë dhe avancojnë këtë lloj sporti në



vendin tonë edhe nëpërmjet organizimit zyrtar në rrugë institucionale", ka thënë ministria Dumoshi. Ajo i uroi sukses rrugëtimit të kësaj federate të re dhe u shpreh se MKRS-ja do të jetë adresë bashkëpunimi dhe mbështetjeje për këtë federatë. Ndërsa kryetari Sllovinja e

falënderoi ministren Dumoshi për pritjen dhe dorëzimin e licencës. Ai e njoffoi ministren me aktivitetet dhe organizimin e federatës, për klubet dhe anëtarët e kësaj federate të re. Sllovinja u shpreh se do të përpilen maksimalisht që Kosovës t'i sjellin sa më shumë suksese në këtë sport.

Messi e njofton Koemanin se e sheh veten larg Barçës

BARCELONA, 21 GUSHT - Ashtu siç ishte njoftuar më herët, Lionel Messi ndërpren pushimet për t'u takuar me trajnerin e ri të Barcelonës, Ronald Koeman, ndërsa përbalja mes të dyve ishte pranuar edhe nga drejtori teknik i katalanëve, Ramon Planes. Ky i fundit e quajti një takim normal atë mes numrit 10 të "blaugranave" dhe trajnerit holandez, por në Spanjë janë të bindur se qëllimi i takimit ka qenë mbi të ardhmen e "pleshtit", që gjithsesi mbetet ende një mister. Burime për mediat spanjolle raportojnë se Messi i ka konfirmuar trajnerit Koeman dyshimet e tij për të vijuar me fanellën e Barcelonës edhe për sezonin e ardhshëm. Siç bëhet me dije, zhgënjimi për humbjen 8-2 ndaj Bayernit ka qenë vetëm i fundit për Lionel



Messi, që ia ka bërë të qartë trajnerit Koeman se e sheh veten "më shumë jashtë sesa brenda projektit të ri të Barcelonës". Pas 19 vjetësh te Barcelona, periudhë në të cilën ka arritur të fitojë gjithçka në karrierë, në nivel individual dhe të klubit, Lionel Messi duket i bindur për të kërkuar një sfidë të re, por nga ana tjetër e ka të

qartë që largimi nuk mund të jetë aq i lehtë, pasi argentinasi ka edhe një vit kontratë me Barcelonën dhe këta të fundit nuk mund të heqin dorë lehtë nga futbollisti më i mirë në botë. Gjithsesi mbetet për t'u parë edhe puna bindëse që do të bëjë Ronald Koeman, i cili ka marrë përsipër ta bindë numrin 10 ta vijojë përvojën te Barcelona.

Futbollisti i Unitedit arrestohet në Greqi

Mbrojtësi i Manchester Unitedit, Harry Maguire, është përfshirë në telashë të premten. Anglezi është arrestuar nga policia në

ishullin grek të Mikonos. Shkak për këtë, sipas raportimeve të fundit, është bërë një sherr që mbrojtësi 27-vjeçar kishte pasur me pushues të tjerë bri-

tanikë në këtë vend. Menjëherë pas këtij sherri ka ndërrhyrë policia, që ka arrestuar Maguiren dhe e kanë marrë atë në pyetje.

SHKURT

Berisha, në formacionin e vitit në Australi

Sulmuesi nga Kosova, Besart Berisha, ka shkëlqyer në këtë edicion në Superligën e futbollit në Australi. Superliga e Australisë ka zgjedhur formacionin më të mirë të sezonit 2019-2020, ku pjesë e tij është edhe sulmuesi nga Kosova, Besart Berisha. A-League ka mbyllur sezonin e rregullt dhe tashmë po zhvillohet faza "play-off" për ta gjetur kampionin e sezonit. Besart Berisha (34-vjeçar) ka qenë ndër më të mirët këtë sezon në A-League. Ndryshe, Berisha ka qenë i papërbajtshëm edhe këtë sezon me golat e shënuar. Futbollisti prishtinas ka shënuar plot 19 gola në 26 ndeshje me Western Unitedin.

Zidane: Do të më pëlgente ta drejtoja Francën

Trajneri Zinedine Zidane ka lënë të hapur mundësinë për ta marrë drejtimin e Kombëtares së Francës pas disa kohësh. "Kam folur edhe në të kaluarën për këtë gjë. Jam trajner ndaj përsë nuk mund ta drejtoj Kombëtaren e Francës? Nuk ka asgjë të re. Nëse do to të ndodhë, është mirë. Të gjithë kanë historinë e tyre, edhe unë me Francën. Përvoja ime me Kombëtaren ka qenë fantastike deri në ndeshjen e fundit (goditi Materazzin në Kupën e Botës dhe u ndëshkua me karton të kuq). Ka pasur ulje dhe ngritje, por historia ime me Francën ka qenë e bukur", ka thënë Zidane.

Edhe Payeti infektohet me Covid-19

Marseille është "goditur" nga koronavirusi dhe për këtë arsy skuadra e Andre Villas Boas nuk do të zbrësë në fushë për javën e parë të kampionatit. Ka shkuar në pesë numri i rasteve me Covid-19 te ky klub. I fundit është kapiteni dhe ylli i skuadrës, Dimitri Payet. Numri 10 i ekipoit është rasti i pestë me Covid në testet e fundit, pas Jordan Amavi, Steve Mandanda, Maxime Lopez dhe Valentin Rongier. "L'Equipe" arriti të zbulojë fillimisht se ka edhe një rast të pestë pozitiv me Covid te Marseille, ndërsa RMC ka konfirmuar se është pikërisht 33-vjeçari Payet ai që ka rezultuar pozitiv.

KV Drita përballe VK Selmy

Prishtinë, 21 gusht - Shorti i tîrhequr në selinë e Konfederatës Evropiane të Volejbollit (CEV) në Luksemburg e ka vënë KV Drita përballë skuadrës çake VK Selmy nga qyteti i Brnos. Ish-kampionia e Kosovës në volejboll, Drita, tash e ka të qartë se Çfarë sfide e pret në rrëthin e parë kualifikues të kupës së CEV-it, njofton FVK-ja. Vëmendja e opinionit të Kosovës ka qenë te skuadra e vetme që do ta përfaqësojë Kosovën në garat evropiane, Klubi i Volejbollit Drita. Drita kundërshtar të parë në Kupën e CEV do ta ketë ekipin që ishte në pozitën e tretë të volejbollit në Çeki në sezonin e shkuar. Ndesheni e parë Drita do ta zhvillojë në Gjilan më 10-12 nëntor 2020, ndërsa ndeshja e kthimit në Brno më 24-26 nëntor 2020. Drita mendohej që filimisht të paraqitet në garën e nivelit të tretë, Challenge Cup, por koeficienti i lartë që ka arritur në garat evropiane, në Ligën e Kampionëve, CEV Cup dhe në garat e tjera, e ka rreshtuar Dritën automatisht në garën e dytë për nga rëndësia në volejbollin evropian, CEV Cup.

Klubi i Volejbollit Drita është i vetmi nga ekipe e Kosovës që sivjet ka paraqitur pjesëmarrjen në Kupat Evropiane, ndërsa te meshkujt shtë pritet prezantimi i Ferizajt në BVA Ligën Ballkanike.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Trepça Shoqeri Aksionare
Trepça Deoničarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Në bazë të nenit 8 të Ligjit të Punës, nenit 22 paragrafi 4 të Statutit të Trepçës, Udhëzimit Administrativ nr.07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, dhe nevojave të paraqitura për plotësimin e disa vendeve të lira të punës, Trepça Sh.A me dt. 22.08.2020 shpal:

KONKURS

Për plotësimin e këtyre vendeve të lira

Të gjitha pozitat janë me afat të përhershëm dhe kohëzgjatja e punës provuese është 3 muaj:

1. Punëtor në montimin e gypave të hidrombushjes (1 pozitë)

a) Detyrat dhe përgjegjësítë:

- Në mënyrë organizative është lidhur me kryepunëtorin dhe mbikëqyrësin e hidrombushjes.
- Punon vetëm në ndërrimin e pare e nëse paraqitet nevoja duhet të vazhdoj edhe në ndërrimin e dytë.
- Puna e tij është e lidhur me montimin dhe demontimin e gypave të hidrombushjes si në horizont ashtu edhe në punishte.
- Gjatë punës së pompave duhet të bëjë kontrollin e linjës së gypave në tër linjën.
- Gjatë ekzekutimit të punëve duhet tu përbahet udhëzimeve të mbikëqyrësit dhe kryepunëtorit.
- Pas kryerjes së punëve është I obliguar të lajmëroj mbikëqyrësin për punët e kryera.
- Punon edhe punët e tjera të cilat ia cakton mbikëqyrësi

b) Kushtet e veçanta dhe dokumentet e kërkua:

- Diplomë të shkollës filllore/mesme

2. Automekanik (1 pozitë – në Fabrika e pajimeve të procesit)

a) Detyrat dhe përgjegjësítë:

- Nën udhëheqjen e udhëheqësit përformon detyrat e dhëna në servisimin e automjeteve.
- Puna me diagnostikim, riparim / ndërrim te pjesëve, konstatimi i defekteve dhe eliminimi i tyre.
- Dhe punë të tjera të profilit të ngjashëm sipas nevojave të ndërmarrjes.

b) Kushtet e veçanta dhe dokumentet e kërkua:

- Diplomë të shkollës filllore/mesme

3. Teknik medicinal në mjekësinë e punës (1 pozitë)

a) Detyrat dhe përgjegjësítë:

- Bën pranimin, evidentimin, protokollimin dhe regjistrimin e punëtorëve në kartotekë;
- Kontrollon dhe sistemon dokumentacionin;
- Kujdeset përfurnizim të rregullt me material të nevojshëm administrativ;
- Harton planin përedukimin e vazdueshëm profesional;
- Pranon dhe përgadit punëtorët përvizit-mjekësore;
- Sipas nevojës i kryen të gjitha shërbimet tjera që i takojnë teknikut të mjekësisë dhe punët e tjera sipas urdhërit të përgjegjësit të QMP-së apo personit tjetër të autorizuar;
- Mbajta dhe evidentimi i rregullit i dokumentacionit mjekësor dhe ofrimi i shërbimeve mjekësore përpunëtorët e Trepçës;

b) Kushtet e veçanta dhe dokumentet e kërkua:

- Diplomë të shkollës mesme

4. Zyrtar përllogaritje të pagave (1 pozitë – Stan Tërg)

a) Detyrat dhe përgjegjësítë:

- Bën llogaritjen e pagave përpunëtorët e njësisë biznesore Miniera me Flotacion Trepça – Stan Tërg
- Bën llogaritjen e normës përpunëtorët të cilët paga e tyre llogaritet me normë në rastet kur mundon zyrtari përllogaritje të normës;
- Kryen edhe punë të tjera të cilat ia cakton punëdhënësi;

b) Kushtet e veçanta dhe dokumentet e kërkua:

- Diplomë universitare nga drejtimi ekonomik

5. Zyrtar përmëditje dhe norma në prodhim (1 pozitë – Stan Tërg)

a) Detyrat dhe përgjegjësítë:

- Bën llogaritjen e normës përpunëtorët të cilët paga e tyre llogaritet me normë;
- Bën llogaritjen e pagave përpunëtorët e njësisë biznesore Miniera me Flotacion Trepça – Stan Tërg në rastet kur mungon zyrtari përllogaritje të pagave;
- Kryen edhe punë të tjera të cilat ia cakton punëdhënësi;

b) Kushtet e veçanta dhe dokumentet e kërkua:

- Diplomë universitare nga drejtimi ekonomik

6. Referente për marrëdhënie pune (1 pozitë – Stan Tërg)

a) Detyrat dhe përgjegjësítë:

- Mirëmban data bazën e pushimeve vjetore, mjekësore dhe të tjera;
- Mirëmban informatat e të punësuarve duke azhurnuar të dhënat e tyre në mënyrë elektronike;
- Mirëmban dhe azhurnon dosjet personale;
- Asiston në përgatitjen e pagave dhe në mungesë të Zyrtar përllogaritjen e Pagave dhe Beneficioneve do ta përgatit Listën e Pagave;
- Informon departamentet kompetente përlivjet e punëtorëve brenda, gjithashtu edhe përpunëtorët e rinx;
- Kontribuon në ekip duke ofruar plotësimin e nevojave dhe rezultatet e punës;

b) Kushtet e veçanta dhe dokumentet e kërkua:

- Diplomë të shkollës së mesme

7. Mirëmbajtës në Stan Tërg (1 pozitë – Stan Tërg)

a) Detyrat dhe përgjegjësítë:

- Të bëjë pastrimin e zyrave të menaxhmentit të Stan Tërgut
- Të bëjë pastrimin e hapësirave të përbashkëta të menaxhmentit të Stan Tërgut

b) Kushtet e veçanta dhe dokumentet e kërkua:

- Diplomë të shkollës filllore/mesme

8. Mirëmbajtës në PIM (1 pozita)

a) Detyrat dhe përgjegjësítë:

- Mirëmban hapësirën brenda Parkut Industrial në Mitrovicë;
- Pastron hapësirën brenda Parkut Industrial në Mitrovicë;
- Kryen edhe punë të tjera të cilat ia cakton punëdhënësi;

b) Kushtet e veçanta dhe dokumentet e kërkua:

- Diplomë të shkollës filllore/mesme

9. Punëtor në Fabrikën e Pajimeve të Procesit (3 pozita)

a) Detyrat dhe përgjegjësítë:

- Mirëmbajtje të pirunierit;
- Mirëmbajtje të paisjeve të punës;
- Sistemimin e veglave të punës;
- Kryen edhe punë të tjera të cilat i jep punëdhënësi;

b) Kushtet e veçanta dhe dokumentet e kërkua:

- Diplomë të shkollës filllore/mesme

10. Manipuluesi i stabilimenteve bartëse kryen këto detyra:

a) Detyrat dhe përgjegjësítë:

- Kontrollon vendin e punës dhe stabilimenteve bartëse para manipulimit;
- Kontrollon motorët, sistemin e frenimit, energjinë elektrike, kontaktet etj;
- Manipulon stabilimentet bartëse ne të gjitha horizontet e minierës;
- Manipulon stabilimentet bartëse ne sinkronizim te plote me sinjalistët;
- Manipulon në bazë të Akustikës dhe sinjalistikës që jepen nga Horizontet dhe Sinjalisti;
- Ndrekundështim paraprake të dhëna nga personeli përgjegjës ne lidhje me ndonjë kufizim;
- Drejtëpërdrejt i përgjigjet udhëheqësit teknik;

b) Kushtet e veçanta dhe dokumentet e kërkua:

- Diplomë të shkollës filllore/mesme

INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT LIDHUR ME PROCEDURAT E KONKURIMIT

Trepça Sh.A., ofron mundësi të barabarta të punësimit përfshirë gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Dokumentet përcjellëse si vijon:

- Dëshmitë përfshirë kualifikimet arsimore dhe profesionale (diplomat e fituara jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara nga MASHT-i),
- Letërnjoftimin kopje,
- Certifikatët nga gjykata që nuk është i dënuar.

Formulari i aplikacionit merret në zyrën e protokollit në Menaxhmentin e Trepça Sh.A dhe dokumentacioni së bashku me formularin e plotësuar duhet të dorëzohet i skanuar në emailin zyrtar të Trepça Sh.A contact@trepacorporation.com

Dokumentacioni i pakompletuar me të dhënat e kërkua do të konsiderohet i pavlefshëm. Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen përfshirë intervistim.

Afati i konkurrimit është 15 ditë nga dita e shpalljes në gazetë deri me datë 05.09.2020.

Kërkosat e dërguara pas datës së fundit të konkurrimit nuk do të pranohen.

Për informata shkëputë, ju lutemi telefononi në numrat: 028/538-050.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Euro Miti" Sh.p.k.Muhovc, Ferizaj, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për stacionin e karburanteve në Hajvali komuna e Prishtinës.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 16.09.2020 në ora 10:00 në hapësirat e restorant "Brilant", që gjendet në anën e djathë të rrugës magjistrale Gjilan-Prishtinë do të organizohet debat publik nga kompania "Euro Miti" Sh.p.k.Muhovc, Ferizaj, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për stacionin e karburanteve në Hajvali komuna e Prishtinës.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/3558674080?pwd=V2VjdIA0WTR0SVVuYmRiZml1YWEhZQT09>

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina
Gjimnazi i shkencave shoqërore "Ahmet Gashi"
Prishtinë



Nr. prot. : 1213/2
Datë: 21.08.2020
Prishtinë

FTESE PËR OFERTË

Gjimnazi i shkencave shoqërore "Ahmet Gashi" Prishtinë, fton të gjitha palët e interesuara që të dorëzojnë ofertat e tyre për :

Furnizim me uniforma shkollore për nxënësit e shkollës sonë

Kërkosat e Këshillit Drejtues së Shkollës janë :

1. Uniformat të janë katër pjesës: këmishë për verë dhe për dimër, xhemper, pantallona
2. Katër pjesët e uniformës të janë me kualitet të lartë dhe të qëndrueshmë (që të mos dëmtohen gjatë pastrimit)
3. Këmishat dhe xhemperi duhet t'a kenë logon e shkollës sonë në pjesën e përparme të tyre
4. Për ngjyra negociohet pasi të vendoset ofertuesi

Të interesuarit duhet të kenë këto dokumente :

1. Certifikatën e regjistrimit të veprimitarisë përkatëse.
2. Çmimin e uniformës.
3. Referencë e ushtrimit të veprimitarisë së tillë.

Vërejtje: Oferta mbetet e hapur 3 ditë prej shpaljes së saj në mjetet e informimit publik.
Të interesuarit, ofertat i dorëzojnë në zarf drejtësore t'ë shkollë.

Prishtinë
21.08.2020



Adresa : Rr. Haxhi Zeka, nr.1, Prishtinë/Republika e Kosovës
E-mail: shml.ahmet.gashi@rks-gov.net
Nr.kontaktes : +383 38 224 678

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

Kërkoj një pastruese për shtëpi. Shtëpi është në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Informatat në tel: 045-336-731

- Meralj Hamza shpall te pavlefshme diplomën shmm "Luciano Motroni" Prizren
- Sulltane Arifi shpall te pavlefshme certifikatën shmlt "11 Marsi" Prizren
- Veton Mekan shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren
- Altin Kryezi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shf "Nazmi Kokollari Budakova" Prizren
- Mentor Qafleshi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shf "Fadil Hisari" Prizren
- Behar Krasniqi shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.

- Mendim Gashi nga Prishtina, shpallë të pavlefshme dëftesat e klasës së -X- dhe -XI- te shkollës "Sami Frashëri" Prishtinë
- Jap banesë me qira afër 60 m², katër III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon. Banesa është e mobiluar komplekt, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

- Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m², me inventar të komplektuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

- Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

- Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muhammed Fejza", banesa është 70 m² dhe i plotëson të gjitha kushtet, katër detyrë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

- Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muhammed Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

- Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përboll "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m², katër detyrë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

- Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian katër i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo t'ë tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpian katër i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo t'ë gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokal më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", katër tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplekt, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qera në qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m², dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



Nr. 05 005-/2020
Tarih: 22.08.2020

03/L-212 nolu Çalışma Yasasının 8. Madde, 04/L-032 nolu Kosova Cumhuriyeti Üniversite Öncesi Eğitimi Yasasının 04/L-032 sayılı kanunu 35. madde, 03/L-068 nolu Kosova Cumhuriyeti Belediyelerinde Eğitim Yasası 5. madde, TEBB 10/2018 sayılı idari talimatlarına göre (Genel Eğitim Mesleki Çerçeve Yönetmenliği), Kamu sektöründe iş ilişkilerinin kurulması için prosedürleri düzenlemek için 07/2017 nolu İT göre Mamuša Belediyesi, Eğitim Müdürlüğü aşağıdaki konkuru ilan etmektedir:

KONKURS

Boş Çalışma Yeri tamamlamak İçin

Türk Dilinde

Mamuša-da Orta, Yüksek Okul "Atatürk" Lisesi,

1. (BIT) Bilgi ve İletişim Teknolojisi dersi öğretmeni 12 ders

Anadolu Okulu, Mamuša

2. (BIT) Bilgi ve İletişim Teknolojisi dersi öğretmeni 24 ders

Adaydan istenilen şartlar;

Koşullar – Boş çalışma iş yerleri için uygun mesleki yeterlilik gereklilik TEBB 10/2018 sayılı idari talimatlarına göre (Genel Eğitim Mesleki Çerçeve Yönetmenliği).

Konkur için gereklili belge

- Aday tarafından doldurulmuş başvuru formu (istem) (BEM 10 no'lu ofisinde alınır)
- Diploma kopyası, onaylatılmış şekilde
- -Aday ülke dışında meczun olmuş işe Eğitim Bakanlığından diploma denkliği
- Profesyonel Seminer Sertifikası, TEBB öngördüğü ve desteklediği
- Doğum belgesi,
- Kimlik kopyası,
- Adayın herhangi bir suç, şiddet veya başka bir suçtan mahkum edilmediğine dair belgelendirme.
- Adayın sağlık sertifikası (adayın işe kabul edilmesi durumunda getirilmesi zorunludur)

Başvuru formu Belediye Eğitim Müdürlüğü'nden alınarak, aranılan tüm evraklar ile birlikte Belediye Eğitim Müdürlüğü'ne teslim edilmektedir.

- Tamamlanmış dokümanlar fotokopi olarak teslim edilir, orijinal belgeler işe mülükattaka sunulur.

- Tamamlanmamış belgeler ve son tarihten sonra gelenler komisyon tarafından dikkate alınmaz.

Konkur gazetede ilan edildiği günden itibaren 15 gün açık kalacaktır.

Not: Konkur için tamamlanmış dokümanlar adaylara tade edit/meyeciktir.

Mamuša Belediyesi
Eğitim Müdürlüğü



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



Br.05/005/2020
Datum: 22.08.2020

Na osnovu Zakona o Obrazovanju u Opština R. Kosova br. 03/L-068, Zakona o Predunderstetskom Obrazovanju R. Kosova br. 04/L-032, član 16. tačka 5 Zakona o Visokom Obrazovanju R. Kosova br. 04/L-037, Administrativno Upustvo br. 17/2009 od 28.08.2009, Administrativno Upustvo br. 06/2015 od 28.07.2018., Administrativno uputstvo br. 05/2018, Opštinski Direktorijat Obrazovanja (ODO) u Mamuši, objavljuje:

KONKURS

za slobodna radna mesta

Na Turskom nastavnom jeziku

Srednja škola(Gimnazija) " Ataturka " u Mamuši

1.Nastavnik . TIK (Teknologija Informacije i Komunikacije) 12 čas.

Uslovi

Osnovna škola "Anadolu" u Mamuši

1.Nastavnik . TIK (Teknologija Informacije i Komunikacije) 24 čas.

- Za sva slobodna radna mesta traže se odgovarajuće profesionalne kvalifikacije, prema administrativnom uputstvu MONT-a (Normativ profesionalnog kadra opštug obrazovanja)

Ne kvalifikovana dokumenta neće se uzeti u razmatranje.

- -Kopija diplome ili sertifikata kao dokaz da je diplomirao/la.
- Nostrifikacija diplome ako je kandidat završio školovanje van Kosova.
- Za radna mesta pomoćnog osoblja traže se kvalifikacije srednje škole , u nedostatku kvalifikovanog kandidata sa srednjom školom, učeće se u obzir i završena osnovna škola.
- -Potvrda radnog staža.
- Profesionalno usavršavanje (seminari).
- Izvod rođenih.
- -Kopija lične karte.
- Aplikacija , koja se dobija u ODO i popunjena se predaje zajedno sa ostalom traženo dokumentacijom u istom Direktorijatu.

Potvrda da kandidat nije osuđivan na zatvorsku kaznu.

- Uverenje o zdravstvenom stanju – samo kandidat koji bude primljen na radno mesto.

- Nepotpuna dokumentacija neće biti primljena.

Konkur ostaje otvoren 15 dana:

Napomena: Prilikom aplikiranja u nastavi na Bosanskom jeziku, kandidati se moraju pridržavati člana 35. takčka 2. Zakona Predunderstetskom Obrazovanju. Kompletan dokumentacija za učešće na konkursu ne vraćaju se kandidatima.

Opštinski Direktorijat Obrazovanja u Mamuši

Direktorijat Prosvete
Opština Mamusa



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



Drejtoria e Arsimit në Mamushë
Nr.05-005/2020
Data: 22.08.2020

Në bazë të nenit 8 të Ligjit të punës nr.03/L-212 nenit 35 Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës nr. 04/L-032, nenit 5 të Ligjit për arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës nr 03/L-068,U/A nr 10/2018 (Normativi mbi kuadrin Professional të arsimt përgjithshëm) U/A nr 07/2017 për rregullimin e procedurave për themelimin e mardhënes së punës në sektorin publik, Drejtoria Komunale e Arsimit në Mamushë shpall këtë:

KONKURS

Për plotsimin e vendit të lire të punës

Në gjuhën turke
Shkolla e Mesme e lartë (Gjimnazi) "ATAÜRK" në Mamushë

1 (një) Mësimdhëns për Teknologji të Informacionit dhe Komunikimit (TIK) 12 orë

Shkolla e Fillore "Anadolu" në Mamushë

1 (një) Mësimdhëns për Teknologji të Informacionit dhe Komunikimit (TIK) 24 orë

kushtet e kërkuara nga kandidatët

Kushtet: - Për vendin e lire të punës kërkohet kualifikimi përkatës profesional, sipas Udhëzimeve Administrative nr 10/2018 dhe 07/2018 të MASHT-it (Normativi mbi kuadrin profesional të arsimt përgjithshëm).

Dokumentacioni i nevojshëm për konkurrim

- Formulari i aplikimit (kërkesa) të cilin e plotëson kandidati (merret në DKA zyra nr.10)
- Kopjen e diplomës të vërtetuar (noterizuar)
- Nostrifikimin e diplomës nëse kandidati e ka të kryer shkollimin jashtë Kosovës(kopja e vendimit nga MASHT- për nostrifikim).
- Certifikatë e seminarit profesional përkrahur dhe e paraparë me MASHT (nëse ka).
- Certifikatën e lindjes.
- Kopjen e letërmjofitimit.
- Vërtetimin se kandidati nuk ka qenë i dënuar për krim, dhunë ose vepra penale tjera. Certifikata mjekësore e kandidatit (është e obligueshme të sillet me rastin e pranimit të kandidatit në punë)

Aplikacionet merren në DKA dhe dorëzohen të plotësuarë së bashku me dokumentacionin e kërkuar në DKA.

- Dokumentet e kompletuar dorëzohen të fotokopjuar, ndërsa dokumentet origjinale prezantohen në intervistë

- Dokumentet e pakompletuar dhe ato që arrijnë pas afatit nuk merren në shqyrtim nga ana e komisionit.

Konkursi mbetet i hapur 15(ditë) nga dita e shpalljes së konkursit në gazetë.

Vërejtje: Dokumentacioni i kompletuar për konkurrim nuk ju kthehet kandidatëve.

Drejtoria e Arsimit
Komuna e Mamushës



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Cjej Punë ofron shërbime
drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshperte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË